



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2018:012561

Datë: 20.09.2024

Numri i dokumentit: 06186556

APS.nr.18/2024

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti Special – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani, kryetar i kolegjit, Afërdita Bytyçi dhe Burim Ademi, anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Fitore Batatina, në çështjen penale kundër të akuzuarit G.E nga fshati O....., Komuna e Pejës, për shkak të veprës penale, Vrasje e rëndë nga neni 147 par.1 pika 4 dhe 9 të KPPK-së (Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës<sup>1</sup>), dhe veprës penale, Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 291 par.5, lidhur me par.1 të KPPK-së (Kodit Penal të Republikës së Kosovës<sup>2</sup>), duke vendosur lidhur më ankesën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK-së), si dhe përgjigjen në ankesën e PSRK-së, të mbrojtëses se të akuzuarit G.E, av. Kosovare Kelmendi, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.191/2020, i datës 26.02.2024, mbajti seancën e kolegjit më datë 24.06.2024, ndërsa me datën 20.09.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

Me aprovimin e ankesës se Prokurorisë Speciale, dhe sipas detyrës zyrtare, ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.191/2020, i datës 26.02.2024, ashtu që i akuzuari G.E, i lindur me datën ..... në fshatin

<sup>1</sup> Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës (Në tekstin e mëtejme KPPK), UNMIK/RREG/2003/25, i datës 06.07.2003, i cili ka hyrë në fuqi më 06.04.2004.

<sup>2</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës (Në tekstin e mëtejme KPRK), nr.04/L-082, i datës 20.04.2012, i cili ka hyrë në fuqi më 01.01.2013.

O, Komuna e Pejës, ku edhe jeton, nga i ati I dhe e ëma V, e vajzërisë Z, i pa martuar, me numër personal: //////////////, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

## Ë S H T Ë F A J T O R

I. Se me datën 02.01.2010, rreth orës 22:45/h, në Pejë, në diskotekën ".....", e cila gjendet në afërsi të sheshit "Haxhi Zeka", me qëllim hakmarrje për t'a privuar nga jeta të dëmtuarin V. K., me këtë rast me dashje eventuale ka privuar nga jeta viktimën B.Sh. dhe ka rrezikuar jetën e të dëmtuarve V. K. dhe A. B. dhe një numri të madh të personave të pranishëm, në atë mënyrë që natën kritike i akuzuari ka hyrë në diskotekën ".....", ku ishin të pranishëm rreth njëmijë (1000) persona duke festuar festën e Vitit të Ri, me qëllim për ta privuar nga jeta V. K. ka nxjerr dy armë, një revole me ngjyrë të zezë ndërkaq tjetra revole me ngjyrë të bronzët dhe ka filluar të gjuaj në drejtim të tij, ku në afërsi të V. krahu për krahu me të ishte viktimë B.Sh., me ç'rast viktimë B. është goditur nga një predhë në gjoks e cila i ka shkaktuar vdekjen e menjëhershme, ndërsa V. K. po ashtu goditet me një predhë në gjoks, me ç'rast është plagosur dhe ka pësuar lëndime të rënda trupore, ashtu që i akuzuari në largim e sipër nga vendi i ngjarjes, me dy armët që i mbante në duar përpjetë ka vazhduar të gjuaj në drejtime të ndryshme brenda lokalit dhe me këtë rast me një predhë e ka goditur të dëmtuarin A. B. në anën e pasme të djathtë të humerusit, duke i shkaktuar lëndime të rënda trupore, e cila ishte në katin e dytë, respektivisht në pjesën e ngritur të diskotekës duke festuar festën e vitit të ri me miqtë e saj dhe po ashtu i akuzuari me gjuajtjet me armë ka vënë në rrezik një numër të madh të personave që ishin duke festuar festën e vitit të ri në diskotekë, pastaj i akuzuari ka dalë nga pjesa e daljes-korridorit të diskotekës.

- më këtë ka kryer veprën penale, Vrasje e rëndë nga neni 147 par.1 pika 4 dhe 9 të KPPK-së.

II. Se me datën 02.01.2010, rreth orës 22:45 minuta, në Pejë, në sheshin "Haxhi Zeka", me armë zjarri ka shkaktuar rrezik të madh për jetën e njerëzve duke rezultuar me lëndim të rëndë trupor të të dëmtuarit H. B., në atë mënyrë që pasi që i akuzuari kishte kryer veprën penale të përshtuar në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe kishte filluar të largohet nga dalja - korridori i diskotekës ".....", në largim e sipër nga vendi i ngjarjes, i akuzuari është vërejtur dhe përcjellur nga i dëmtuari – zyrtari policor H. B., i cili nuk ishte në detyrë zyrtare natën kritike, por ishte në

diskotekë duke festuar festën e vitit të ri, ashtu që nën përcjellje i vihet pas duke e ndjekur të akuzuarin, nga diskoteka dhe jashtë në rrugët e qytetit të Pejës, ashtu që me të dalë jashtë, i dëmtuari e kishte nxjerrë pistoletën e tij zyrtare dhe i ishte vërsulur pas duke e ndjekur të akuzuarin i cili po ikte përgjatë trotuarit të sheshit “Ardian Krasniqi”, në të cilin ishte një numër i madh i qytetarëve duke lëvizur, ashtu që i akuzuari ka gjuajtur në ajër dy herë, për t’u liruar rruga derisa ishte duke ikur dhe ka vazhduar të vrapoj në drejtim të lokalit “....” dhe kur i dëmtuari H.B., i kishte urdhëruar “ndalo policia”, i akuzuari e ka kthyer dorën mbrapa dhe ka gjuajtur në drejtim të dëmtuarit me pistoletën e tij të tipit “....”, model ..., e kalibrit 9x19mm, me numër serik: U .... dhe përsëri i akuzuari ka vazhduar të ikë dhe i dëmtuari ka vazhduar ta ndiqte pas, dhe kur përsëri i dëmtuari i është drejtuar duke urdhëruar “ndalo policia se i’u gjuaj drejtë në kokë”, i akuzuari përsëri ka kthyer dorën mbrapa dhe ka shtënë në drejtim të dëmtuarit H. B. me armën e lartpërmendur, pastaj i dëmtuari ndalet tek Foto “....”, i shtangur dhe i mpirë nga predha e armës së lartpërmendur që e kishte goditur në pjesën e epërme të regjionit femoral të këmbës së djathtë, me ç’rast të dëmtuarit i ka shkaktuar lëndime të rënda trupore, ndërsa i akuzuari ka vazhduar të ikë në drejtim të “Raiffeisen Bank”.

- më këtë ka kryer veprën penale, Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 291 par.5, lidhur me par.1 të KPPK-së.

-

Andaj, gjykata në mbështetje të nenit 6, 11 par.1, 34, 35, 36 par.1 dhe 2, **37**, 38, 54 par.1 dhe 2, nënpar.7, 60, 64, 65, 71 par.1 dhe 2 nënpar.1 dhe nenet 147 par.1 pika 4 dhe 9 dhe 291 par.5 lidhur me par.1 të KPPK-së, si dhe neni 364 të Kodit të Procedurës Penale, të akuzuarit G. E., i’u përcakton dënimet si në vijim:

Për veprën penale të Vrasjes së rëndë nga neni 147 par.1 pika 4 dhe 9 të KPPK-së, të përshkruar në pikën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, dënim me burgim afatgjatë në kohëzgjatje prej njëzetekatër (24) viteve;

Për veprën penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 291 par.5 lidhur me par.1 të KPPK-së, të përshkruar në pikën II. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, dënim me burgim në kohëzgjatje prej katër (4) viteve;

Gjykata, në kuptim të nenit 71 par.1 dhe 2, nën par.1 të KPPK-së, të akuzuarin e;

G J Y K O N

Më dënim me burgim afatgjatë në kohëzgjatje prej njëzetekatër (24) viteve, në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 25.10.2016, e deri më datë 30.11.2023.

Ndaj të akuzuarit, shqiptohet:

#### Dënimi Plotësues

Konfiskohet një (1) pistoletë e tipit “.”, model P., e kalibrit 9x19 mm, me numër serik: U . . . ., së bashku me dhjetë (10) fishekët e kalibrit 9x19 mm, si objekte të kryerjes së veprave penale.

Urdhërohet Stacioni Policor në Pejë, që pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi të bëjë shkatërrimin e armës së konfiskuar, që në polici evidentohet sipas numrit të rastit 2010-DI-002 dhe 2010-DA-019.

Detyrohet i akuzuari që t’i paguajë shpenzimet e procedurës penale në shumën prej pesëqind euro (500 €), shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumën prej treqind euro (300 €), si dhe në emër të programit për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej pesëdhjetë euro (50 €), të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të dëmtuarit: B. Sh., H. B., Xh. K. dhe A. B., për realizimin e kërkesës pasurore - juridike udhëzohen në kontest të rregullt juridiko-civil.

Të akuzuarit G. E., i caktohet masa e paraburgimit e që gjykata do të lëshojë aktvendim të veçantë.

#### **A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Gjakovë - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin, PKR.nr.191/2020, i datës 26.02.2024, të akuzuarin G. E., konform nenit 363 par. 1, nënpar. 1.3 të KPPK-së, e ka liruar nga aktakuza për veprën penale, Vrasje e rëndë nga neni 147 par.1 pika 4 dhe 9 të KPPK-së, dhe veprën penale, Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 291 par.5, lidhur me par.1 të KPPK-së, pasi që nuk është provuar se ka kryer këto vepra penale për të cilat është akuzuar.

Të dëmtuarit H. B., A. B., Xh. K. dhe B. Sh. për realizimin e kërkesës pasurore juridike, janë udhëzuar në kontest civil.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka ushtruar Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384 par. 2, nënpar. 2.7 të KPPK-së, dhe vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 386 par. 1 të KPK-së, më propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, t'a ndryshoj aktgjykimin e ankimuar ashtu që të akuzuarin G.E t'a shpall fajtor për veprat penale për të cilat është akuzuar dhe t'a dënoj me dënim meritator sipa Kodit Penal, ose aktgjykimin e ankimuar t'a anuloj dhe çështjen t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesën e Prokurorisë Special të Republikës së Kosovës, ka ushtruar mbrojtësja e të akuzuarit G.E, av. Kosovare Kelmendi, me propozim që ankesa e Prokurorisë Speciale të refuzohet si e pa bazuar ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Prokuroria e Apelit me parashtrësën, PPA/I.nr.268/2024, datë 15.05.2024, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Speciale, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.191/2020, i datës 26.02.2024, të ndryshohet ashtu që i akuzuari G.E të shpallet fajtor për veprat penale për të cilat është akuzuar dhe të dënohet sipas ligjit, ose aktgjykimi të anulohet dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje, ndërsa përgjigjeja në ankesë të Prokurorisë Speciale e ushtruar nga mbrojtësja e të akuzuarit G.E, av. Kosovare Kelmendi, të refuzohet si e pa bazuar.

Gjykata e Apelit caktoi dhe mbajti seancën e kolegjit në pajtim me dispozitën e nenit 390 të KPPK-së në të cilën mori pjesë mbrojtësja e të akuzuarit G.E, av. Kosovare Kelmendi, ndërsa nuk moren pjesë: i akuzuari G.E, të dëmtuarit H.B, A. B., Xh. K., B. Sh. dhe as Prokurori i Apelit, edhe pse kanë qenë të njoftuar në mënyrë të rregullt gjyqësore për kohën dhe vendin e mbajtjes së seancës, andaj, seanca e kolegjit u mbajt konform nenit 390 par. 4 të KPPK-së, në mungesë të tyre. Mbrojtësja e të akuzuarit G.E, av. Kosovare Kelmendi, deklarojë se mbetet pranë përgjigjes se ushtruar me shkrim kundër ankesës së Prokurorisë Speciale, duke i propozuar Gjykatës së Apelit që aktgjykimin e ankimuar t'a vërtetoj.

Gjykata e Apelit pasi që ka studiuar aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore të Prokurorisë Speciale, përgjigjen në ankesë të mbrojtëses se të akuzuarit, propozimin e Prokurorisë së Apelit, dhe duke analizuar shkresat e lëndës në këtë çështje penale në vështrim të nenit 394 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale, gjeti se:

*Ankesa e Prokurorisë Speciale, është e bazuar.*

*Pretendimet ankimore të Prokurorisë Speciale*

Prokurori Special në ankesë pretendon se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.2, nënpar. 2.7 të KPPK-së, ngase aktgjykimi nuk është përpiluar në pajtim me nenin 369 të KPPK-së, duke qenë se dispozitivi i aktgjykimit është në kundërshtim me brendinë e tij, me arsyetimin si dhe me faktet vendimtare dhe me përmbajtjen e provave materiale të administruara gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësorë andaj edhe si i tillë aktgjykimi është i pa qëndrueshëm, dhe si pasojë e shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale ka ardhë edhe deri të konstatimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike. Se është i pa qëndrueshëm konstatimi i gjykatës së shkallës së parë se kinse me asnjë provë nuk është vërtetuar se i akuzuari G.E të ketë kryer veprat penale që i vihen në barrë ngase provat materiale të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësorë vërtetojnë të kundërtën e asaj që ka gjetur gjykata e shkallës së parë.

Prokurori më tutje në ankesë ka përshkruar analizimin dhe vlerësimin e provave të administruara nga gjykata shkallës së parë duke filluar nga faqe 94, pika 9 e deri të faqe109 pika 9.2, e aktgjykimit të ankimuar duke pretenduar se me këto prova vërtetohet se i akuzuari G.E ka kryer veprën penale, Vrasje e rëndë nga neni 147 par.1 pika 4 dhe 9 të KPPK-së, dhe veprën penale, Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 291 par.5, lidhur me par.1 të KPPK-së.

Më tutje në ankesë prokuroria ka paraqitur dëshmitë e dëshmitarëve të cilët janë dëgjuar gjatë shqyrtimit gjyqësor nga gjykata e shkallës së parë dhe dëshmitë e tyre janë vlerësuar me aktgjykimin e ankimuar dhe atë dëshmitarët: R.M, Sh.B, ekspertit të balistikës Ilir Kukaj, leximit të deklaratave të dëmtuarve përkatësisht dëshmitarëve, përfaqësuesit ligjor i tani të ndjerit B.Sh., të dëmtuarit-dëshmitarit H.B, dëshmitarit XH.K, dëshmitari D.C, I.F, A.B, V. T., Sh. T., K. H., deklaratat e lexuara nga procedura e mëhershme të dëshmitarëve K. K., I. H., V. T., A. B., A. B., L. M., dhe dëshmitarja B. S.. Po ashtu, edhe deklaratat e lexuar të dëmtuarit-dëshmitarit V. K., mendimin e eksperti mjeko ligjor, Dr. Naim Uka, të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësorë për të dëmtuarin H. B., dëshminë e dëshmitarit të propozuar nga mbrojtja T.K..

Prokurori në ankesë ka thekësuar se deklaratat e dëshmitarëve: T.H, R.H. dhe I.H të ndryshuara në krahasim me dëshmitë e tyre të më hershme janë të pa besueshme ngase fillimisht në intervistën e parë R.H. ka deklaruar se në shtëpinë e tyre pasi që u kthyen nga shtëpia e prindërve të saj rreth orës 22-23, kishte dëgjuar një automjet duke u vozitur shpejtë e që G. arriti në shtëpinë e tyre e që vërteton kohën kur i akuzuari iku me automjetin që ishte duke e pritur.

Prokurori konsideron se më plotë të drejtë mund të konstatohet se është vërtetuar se i akuzuari G.E. ka kryer veprat penale që i vihen në barrë ngase në mënyrë të pa kontestueshme është vërtetuar se më datë 03.10.2010, me rastin e shkuarjes në kërkim të personit të dyshuar në shtëpinë e T. H. në fshatin R..., nën jastëkun e shtratit të tij, në dhomën ku ishte duke fjetur G. E. është gjetur arma e zjarrtë e cila pas egzaminimit balistik të datës 29.01.2010, ka rezultuar se kemi të bëjmë me pistoletën e llojin ". ", model P ... kalibër 9x19 mm, me nr. serik .... dhe se ka rezultuar se gëzhojat e evidentuara me shenjën EX2, EX3 si dhe EX7 dhe një Plumb i evidentuar EX39 që është nxjerr nga trupi i zyrtarit policor H. B., janë nga pistoletat "Sig Sauer".

Pretendimi i mbrojtjes se arma e G. E. nuk është arma që ishte ekzaminuar dhe për këtë kinse nuk mund të bindet as një vëzhgues objektivë që arma e cila është gjetur nën jastëkun e G.E., natën kritike, e njëjta është dërguar për ekzaminim të forenzikës pra arma "Sig Sauer", ngase arma që është dërguar në forenzikë për ekzaminim së bashku me zingjirin e ruajtjes, sipas urdhëresës së policisë që mban shënimin "Sig Sauer", 9 mm, me numër 4421774. Sipas vlerësimit të prokurorisë edhe ky pretendim i mbrojtjes është i pabazuar dhe me qëllim të krijimit të konfuzionit lidhur me armën e cila i është gjetur të akuzuarit ngase provat nga ana e mbrojtjes analizohen në mënyrë të përgjithësuar, dhe ky pretendim është në kundërshtim me provat dhe dëshmitë e dëshmitarëve të cekura si më lartë.

Nuk është kontestues fakti se nga i akuzuari G.E është sekuestruar arma "Sig Sauer", e cila vërtetohet nga lista e armëve të konfiskuara, e datës 03.01.2010, e cila është e nënshkruar nga ana e vet të akuzuarit natën kritike në ora 3:00 h, të mëngjesit kur ishte intervistuar dhe kishte pranuar se arma ishte e tij gjatë deklaratës në polici.

Sa i përket numrit serik të amës, Prokuroria vlerëson se nëse shikohet lista e armëve me të cilën është konfiskuar arma nga ana e të akuzuarit natën kritike, sipas një shikimi të lirë - vizual të kësaj shkrese, shihet qartë se numri i armës së sekuestruar sipas kësaj liste është U 421 774 dhe jo numri siç pretendon mbrojtja. Po ashtu, deri tek ky vlerësim ka ardhur për shkak se në pjesën ku është shënuar me dorë numri serik i armës tek lista mbi sekuestrimin e armës, forma e shkruar e shkronjës "U", dallon shumë qartë nga format e dy numrave tjerë që janë shënuar si numra "4" të cilët janë pjesë e numrit serik të armës. Prandaj, është i saktë konstatimi dhe pretendimi i mbrojtjes që në urdhëresën e gjykatës kur ishte dërguar për ekzaminim ishte shënuar gabimisht numri "4" në vend të shkronjës "U", të cilin fakt e ka konstatuar edhe eksperti i balistikës se urdhëresa për ekzaminimin e armës "Sig Sauer", ka ardhur me numrin

4421774, mirëpo është vërtetuar se lista e armëve të sekuestruara nga ana e të akuzuarit e datës 03.01.2010, ka përputhshmëri të plotë me mendimin e ekspertit të balistikës Ilir Kukaj, i cili ka konstatuar se arma mban numrin serik: U 421 774.

Sa i përket pretendimit të mbrojtjes se nuk është arma "Sig Sauer", arma e cila i është gjetur nën jastëk të akuzuarit natën kritike e cila më pas është dërguar për ekzaminim në forenzik, ky pretendim po ashtu është i pabazuar, për shkak se siç është theksuar me lartë nga lista për sekuestrimin e armës të cilën e kishte nënshkruar vet i akuzuari vërtetohet se arma ishte e tij. Kjo listë përputhet në tërësi me raportin e oficerëve policor Riza Mahaj dhe Shpend Berisha, të datës 04.01.2010, në të cilin raport konstatohet se "vlen të theksohet se G.e pranon se arma "Sig Sauer" është e tij dhe se të njëjtën e ka gjetur" pra, ky raport është i datës 04.01.2010, përveç që konstatohet se arma e G. ishte "Sig Sauer", ky raport përputhet në tërësi edhe me deklarinimin e të akuzuarit në polici, i cili për armën kishte deklaruar se kinse e kishte gjetur duke shkuar rrugës për në fshatin R... Në këtë drejtim edhe dëshmitari Sh.B., gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se, "në atë shtrat, nën jastëk ku ishte duke fjetur G. është gjetur arma - pistoleta "Sig Sauer". Edhe dëshmitari Riza Mahaj, gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se "sipas Shpendit, arma ka qenë Sig Sauer, çka nuk na është lidhur me vendin e ngjarjes, e që kjo ka qenë arsyeja që nuk na është dukur shumë e rëndësishme". Pra, përveç listës së armëve të sekuestruara, ekziston edhe raporti i oficerëve dhe dëshmia e dëshmitarëve të lartpërmendur, nga të cilat vërtetohet se arma e cila i ishte gjetur të akuzuarit nën jastëkun e tij, ishte arma "Sig Sauer", e cila armë po ashtu është dërguar edhe në ekzaminim balistik.

Po ashtu për sa i përket kundërshtimit të mbrojtjes përkitazi me veprimet e policisë me rastin e hyrjes në shtëpinë e T. H. duke i'u referuar nenit 245 par. 1 të Kodit të Përkohëshëm të Procedurës Penale të Kosovës i cili ka qenë në fuqi në atë kohë, konstatohet si në vijim:

Kur është e domodoshme dhe në masë të nevojshme, policia mund të hyjë në shtëpinë dhe lokalet tjera të personit dhe të zbatojë kontrollin pa urdhrin e gjyqtarit të procedurës paraprake nëse:

- 1) Personi përkatës me dije dhe me vullnet pajtohet me kontrollin;
- 2) Personi thërret për ndihmë;
- 3) Kryerësi i kapur në flagrancë gjatë kryerjes së veprës penale duhet arrestuar pas ndjekjes;
- 4) Arsyet për mbrojtjen e njerëzve dhe pasurisë e kërkojnë një veprim të tillë ose



5) Personi kundër të cilit është lëshuar urdhërarrest nga gjykata gjendet në shtëpi apo në lokale të tjera.

Në rastin konkret janë plotësuar kushtet nga neni 245 par. 1, nënpar. 3 të Kodit të Përkohëshëm të Procedurës Penale të Kosovës.

Gjithashtu mbrojtja ka propozuar që si provë e papranueshme të shpallet arma e sekuestruar me datën 02.01.2010, në fshatin Ramun, Komuna e Pejës, në shtëpinë e T.H., për shkak se është bërë në mënyrë të kundërligjshme bastisja pa urdhëresë të gjykatës dhe për rrethana tjera të cekura si në procesverbal, gjithashtu gjykata edhe këtë propozim të mbrojtjes e ka refuzuar si të pabazuar për faktin se për të njëjtin propozim, si dhe me të njëjtat pretendime që mbrojtja i ka dhënë edhe gjatë shqyrtim gjyqësor lidhur me këtë provë, përkatësisht lidhur propozimin për shpalljen e armës së sekuestruar si provë të papranueshme, për këtë çështje ishte vendosur me aktvendim të veçantë dhe të arsyetuar nga ana e Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti për Krime të Rënda, numër PKR.nr.253/2016, të datës 23.01.2017, i cili aktvendim ishte bërë i plotfuqishëm, pra, ishte vërtetuar nga ana e Gjykatës së Apelit të Kosovës, me Aktvendimin, PN.nr.252/2018, të datës 30.03.2018. Po ashtu, gjykata ka vlerësuar se me rastin e kthimit të kësaj çështje në rivendosje nga ana e Gjykatës së Apelit të Kosovës, me aktvendimin, PAKR.nr.434/2018, të datës 16.10.2018, Gjykata e Apelit lidhur me këtë provë nuk kishte gjetur se është bërë ndonjë shkelje me administrimin e kësaj provë gjatë shqyrtimit të kaluar gjyqësor, kur i akuzuari është shpall fajtorë edhe përkundër faktit se mbrojtësi i atëhershëm i të akuzuarit, avokati Ndrecë Dodaj, në ankesën e tij kundër aktgjykimit i cili është anuluar, ishte thirrur për të njëjtin pretendim siç është thirrur mbrojtja e tanishme e të akuzuarit, av.Kosovare Kelmendi dhe av. Bujar Bërdynaj, sa i përket kësaj prove. Prandaj duke qenë se Gjykata e Apelit me rastin e kthimit në rivendosjes nuk ka bërë ndonjë rekomandim rreth vlerësimit të serishëm të kësaj prove, kjo gjykatë ka konsideruar se kjo provë është e pranueshme, pasi që për të njëjtën është vendosur me aktvendim të veçantë i cili armën e ka shpallur si provë të pranueshme, ashtu që ky aktvendim ka qenë i arsyetuar mjaftueshëm dhe është vërtetuar nga ana e Gjykatës së Apelit të Kosovës.

Gjykata e shkallës së parë me arsyetim se duke u bazuar në rekomandimet e Gjykatës Supreme të Kosovës, sipas aktgjykimit PML.NR. 88/23, të datës 20.07.2023, apriori konstaton gabimisht se të gjitha veprimet e zyrtarëve policorë në shtëpinë e T. H. në fshatin Ramun kanë qenë të kundërligjshme.

Rekomandimi i Gjykatës Supreme, veçmas në pikën II. konsiston se natën kritike a bëhet fjalë për kontrollë apo ndonjë institut tjetër të procedurës penale në raport me të akuzuarin G.E dhe sekuestrimin e armës së zjarrtë. Në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me kontrollë të shtëpisë dhe objekteve përcjellëse por zyrtarët policorë kanë vepruar në kërkim të personit të dyshuar atëherë Sh. H. dhe se me pëlqimin e pronarit të shtëpisë kanë hyrë në shtëpi dhe me atë rast kanë hasur në të akuzuarin G.E i cili nën jastak në shtratin ku ishte duke fjetur kishte pasë armën e llojit “Sig Sauer”, të përshkruar si në raport policor e që edhe pas ekzaminimit nga ana e ekspertit të balistikës të ketë rezultuar se e njëjta është përdorë në plagosjen e të dëmtuarit - zyrtarit policorë, H.B..

Sipas rekomandimeve të Gjykatës Supreme është ndëgjuar prapë eksperti Ilir Kukaj i cili në detaje ka sqaruar se arma e llojit “Sig Sauer”, e ekzaminuar përputhet me dëshminë numër 7 (gëzhoja) i përket revoles të llojit "Sig Sauer", model P 226, kalibër 9x19 mm me nr. serik U421774, si dhe një plumb i evidentuar EX39, që është nxjerr nga trupi i zyrtarit policor Hasan Buqaj.

Prokurori konsideron se gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes së kësaj çështje penale - juridike ka vlerësuar vetëm provat të cilat shkojnë në favor të të akuzuarit e duke u thirrur në institutin juridik 'In dubio pro reo', ka anashkaluar faktin vendimtar se arma e cila është sekuestruar nga i akuzuari pas ekzaminimit balistik ka rezultuar se nga e njëjta armë është plagosë i dëmtuari H. B.. Nuk ka dilemë se e njëjta armë është sekuestruar nga i akuzuari G.E. Askush e as zyrtarët policorë nuk kanë pasë kurfarë interesi që t'ia ndërrojnë armën e sekuestruar nga i akuzuari e cila armë përmes zinxhirit të ruajtjes ka përfunduar në ekspertizë balistike. Andaj, nga të cekurat Prokuroia Specila ka propozuar si më lartë.

*Përgjigjeja në ankesë të Prokurorisë Speciale e mbrojtëses se të akuzuarit G.E, av. Kosovare Kelmendi*

Mbrojtësja e të akuzuarit, në përgjigje në ankesë ka thekësuar se ankesa e Prokurorisë Speciale jo vetëm që është e pabazuar por e njëjta bazuar në pretendimet e paraqitura në ankesë qartazi rezulton se është një ankesë e parashtruar formalisht pa pretendime të qarta ankimore ndaj aktgjyqimit të atakuar e po ashtu e njëjta përmban edhe disa çështje të pa vërteta. Lidhur me pretendimet e Prokurorisë se aktgjykimi i shkallës së parë është i përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.2 nën par.2.7, ngase aktgjykimi nuk është

përpiluar në pajtim me nenin 369 të KPPRK-së, një pretendim apo konstatim i tillë i prokurorisë jo vetëm se nuk qëndron, por shifet qartazi se është vetëm parafrazim i dispozitës ligjore, pa u paraqitë asnjë fakt apo rrethanë se ku konsiston shkelja esenciale, pra pa paraqitur asnjë fakt, se ku konsiston kundërthënia e dispozitivit të aktgjykimit me përmbajtjen e tij apo me provat materiale, apo me faktet vendimtare. Prokurori special, në ankesën e parashtruar, nuk ka cekur fare se ku konsiston shkelja e nenit 369, e cila dispozitë ligjore përmban 12 paragrafe, pra, nuk është e qartë se cilin element apo kusht nga kjo dispozitë nuk e plotëson aktgjykimi i atakuar.

Gjykata e shkallës së parë, në arsyetim të aktgjykimit, ka paraqitur detajisht se cilat prova janë administruar, ka analizuar që të gjitha këto prova një nga një, për çdo pikë dhe në tërësi, se në arsyetimin e aktgjykimit konform dispozitës ligjore nga neni 369 par.10 të KPPRK-së, gjykata ka paraqitur veçanërisht arsyetimin e paraparë sipas nenit 363, me të cilin të akuzuarin e ka liruar nga akuza.

Në përgjigje në ankesë mbrojtësja e të akuzuarit lidhur me bazën e dytë ligjore – vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, ka theksuar se të gjitha provat materiale, të cilat Prokurori Special i ka radhitur në ankesën e tij janë të përfshira në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar, janë vlerësuar detajisht dhe në mënyrë analitike dhe tejet profesionale një nga një dhe bashkarisht se pikërisht bazuar në të gjitha provat, gjykata e shkallës së parë për të vendosur drejtë dhe në mënyrë ligjore duke e vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të saktë gjendjen faktike domosdo se të akuzuarin G.E., nuk ka pasur asnjë mundësi ligjore që ta shpallë fajtor.

Prokurori Special, në ankesën e tij pretendon se mbrojtja me qëllim i analizon provat në mënyrë të përgjithësuar, duke e vënë në kofuzion gjykatën e shkallës së parë, mbrojtja shton se një pretendim i tillë jo vetëm që nuk qëndron, por për të bind kolegjin penal të Gjykatës së Apelit se pikërisht është Prokurori Special ai i cili përpiket ta vëj në konfuzion dhe madje edhe lajthim gjykatën instanciale, mbrojtja e potencon faqën 19 të ankesës së prokurorit, i cili, me rastin e veprimeve të policisë në shtepine e T.H. në Ramun, i referohet dispozitës ligjore nga neni 245 par. 1 të KPPPK-së, duke i radhitur 5 paragrafet e parapara në këtë dispozitë ligjore të cilat e arsyetojnë kontrollin e kryer pa urdhër të gjykatës, por qëllimisht e anashkalon paragrafin 6 i cili në mënyrë imperative obligonte policinë e cila kur ndërmerr kontroll pa urdhër të shkruar gjyqësor brenda afatit prej 12 orësh pas kontrollit duhet ti dërgoj raport prokurorit dhe gjyqtarit

që të merret aprovimi retroaktiv gjyqësor i kontrollit e që është edhe në pajtim me dispozitat kushtetuese.

Kushtetua e Republikës së Kosovës, në nenin 36 par 2, qartë e përcakton se kontrolla e çdo banese apo hapësire private e domosdoshme për kryerjen e hetimeve rreth krimeve mund të bëhet vetëm sipas shkallës së paraparë dhe vetëm në bazë të vendimit gjyqësor pas sqarimit të arsyes për ndërmarrjen e asaj kontrole dhe largimi nga kjo rregull është e lejueshme nëse është i nevojshme lidhur me arrestimin ligjor të kryesit të veprës penale, mbledhjes së dëshmive të cilat mund të humben apo në rast të evitimit të rrezikshmërisë serioze dhe të atëçastshme për njerëz dhe pasuri, të përshkruara me ligj. Gjykata është e obliguar ti lejoj këto veprime në mënyre retroaktive.

Edhe Kodi i Procedurës në fuqi, me saktësisht dispozita ligjore nga neni 108 par. 2 dhe 3 e rregullon qartë këtë çështje, ndërkaq që neni 109 përcakton papranueshmërinë e provave të cilat janë marrë gjatë kontrollit nëse kontrolli ishte zbatuar në shkelje të rëndë të dispozitave nga ky kapitull.

Çfarë dhe si ishte kryer kontrolli dhe sekuestrimi i armës në fshatin Ramun? Ajo që ka ndodhur me rastin e asaj kontrole - bastisje dhe mënyra e konfiskimit të asaj arme, duke munguar urdhëresa retroaktive e gjykatës, duke munguar prezenca e krim teknikes me rastin e gjetjes së armës, duke munguar fotografimi i armës së gjetur si dhe personit afër armës e cila i ishte gjetur, tërheqja e armës ashtu sikurse e rregullojnë dispozitat ligjore për sigurimin dhe sekuestrimin e një prove, absolutisht dhe në mënyrë të pakontestueshme paraqesin prova të papranueshme, sepse, pikërisht kjo mënyrë e kontrollimit dhe sekuestrimit të armës, eskivazhet të cilat hetuesit policor i kanë bërë me rastin e deklarimeve se kush e ka tërhequr armën, janë pikërisht fakte që vejnë në dyshim se a behet fjalë për armën e njëjtë dhe të gjitha këto pa mëdyshje dëshmojnë se atë natë respektivisht atë ditë vendi i ngjarjes është kontaminuar, provat janë manipuluar dhe me besueshmëri të lartë duke i ndërlidhur të gjitha këto fakte njëra me tjetrën, dërgojnë në një përfundim se arma e G.E nën jastek nuk është arma e ekzaminuar në laborator dhe si mund të bindet një vëzhgues objektiv se arma e gjetur nën jastekun e G., është arma e njëjtë kur mungon fotografia e armës nga krim teknika, mungon fotografia e armës në polici, mungojnë shënimet e armës në deklaratën e të dyshuarit të dhënë në polici, mungon emri dhe mbiemri i policit i cili e ka plotësuar dokumentin mbi konfiskim me shënimet Sig Sauer, 9mm 4421744 pa shënime të llojit të asaj arme, me numër serik gabim, mungon vërtetimi mbi konfiskimin e që as të dyshuarit nuk i është dorëzuar e që kjo është kundërligjore pra si të bindet dikush me gjithë këto pa rregullsi dhe mangësi se bëhet fjalë për të njëjtën armë, ndërsa R. M.

përgjigjet: me mirëbesim kolegjial. Mbrojtja në përgjigje në ankesë i ka propozuar Gjykatës së Apelit që ankesën e Prokurorit Special, t'a refuzoj si të pa bazuar, ndërkaq aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, t'a vërtetoj.

### *Të gjeturat e Gjykatës së Apelit*

#### *Të gjeturat për pretendimet ankimore për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale*

Kolegji Penal i Gjykatës së Apelit, vlerëson se pretendime ankimore sa i përket shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nuk janë të bazuara, pasi që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk ka kundërthënë ndërmjet dispozitivit dhe arsyeve të dhëna, se në arsye e dhëna gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar dhe ka dhënë arsye për provat që janë administruara në shqyrtimin gjyqësor, prandaj si të tilla pretendimet e prokurorisë për shkelje të dispozitave të procedurës penale kjo Gjykatë i vlerëson si të pabazuara. Mbi këto arsye kjo Gjykatë gjen se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i përfshirë me shkelje të dispozitave procedurale nga neni 384 par. 2 nën par. 2.7 të KPPK-së. Gjykata e Apelit vëren se pretendimet ankimore sa i përket shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale shtrihen në raport me mënyrën e vlerësimit të provave, gjë që mënyra e vlerësimit të provave përveç kur është haptas arbitrare do të konsistonte në cenimin e nenit 369 dhe nenit 360 të KPPK-së, e që ndërlidhet me nenin 384 paragrafi 2, nënparagrafi 2.7 të KPPK-së.

#### *Të gjeturat lidhur me pretendimet ankimore për vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.*

Kolegji Penal i Gjykatës së Apelit pretendimet ankimore të Prokurorisë Speciale për vërtetim të gabuar të gjendjes faktike i gjen të bazuara, për çka edhe e ka ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe ka shpallur fajtor të akuzuarin, duke gjetur se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka vërtetuar gjendjen faktike, e kjo për shkak të konkluzioneve të gabuara që janë nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë kur të akuzuarin e ka liruar tërësisht nga akuza. Kjo Gjykatë gjen se në veprimet e të akuzuarit G.E konsumohen elementet e veprës penale, Vrasje e rëndë nga neni 147 par.1, pika 4 dhe 9 të KPPK-së, dhe veprës penale, Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 291 par.5, lidhur me par.1 të KPPK-së.

Kolegji ka analizuar me shumë kujdes të gjitha provat të cilat janë administruar gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor nga gjykata e shkallës së parë dhe të njëjtat i vlerësoj një nga një dhe në lidhmëri me njëra tjetrën konform nenit 362 par. 2 të KPPK-së, dhe gjeti se ka prova të

mjaftueshme që dëshmojnë se i akuzuari Granit Elshani ka kryer veprat penale për të cilat është akuzuar.

Nga provat e administruara Kolegji Penal i Gjykatës se Apelit ka vërtetuar se: me datën 2 janar 2010 në Pejë, meqenëse ishte festë, nata e dytë e vitit të ri, në diskotekën “.....”, ku pronar ishte tani i ndjeri viktima B. Sh.dhe A. B., ishte organizuar mbrëmje muzikore me këngëtarin N.. Atë natë në diskotekë kishte rreth njëmijë (1000) mysafir (persona) të cilët kishin shkuar në diskotekë për të festuar Vitin e Ri dhe po ashtu kishte edhe persona që e bënë sigurimin e diskotekës, pra që bënë kontrollë para hyrjes në diskotekë dhe që mbanin rendin brenda saj. Në diskotekë pothuajse për çdo mbrëmje që organizohej, ishte si rregull që gjatë mbrëmjes fillimisht u hapte tavani i diskotekës, gjuhej me fishekzjarrë nga brenda jashtë tavanit të hapur. Edhe natën kritike ishte vepruar njësoj, gjatë mbrëmjes ishin gjuajtur fishekzjarre, pra para se të gjuante me armë brenda diskotekës personi që i kishte në duar dy armë, e që nga provat është vërtetuar se ishte i akuzuari G.E. Pothuajse të gjithë dëshmitarët kanë theksuar se kur kishin dëgjuar krismat fillimisht kishin menduar se janë përsëri fishekzjarre, derisa e kishin parë personin që ishte afër binës me dy pistoleta në duar dhe po gjuante afër binës në diskotekë dhe në drejtime të ndryshme gjatë largimit të tij. Të gjithë dëshmitarët që janë dëgjuar në këtë rast kanë dëshmuar se të gjithë mysafirët (personat) që ishin prezent aty nga frika që personi po gjuante me armë, ishin shtrirë për toke. Nga gjuajtja me armë që kishte bërë personi tani i akuzuari, afër binës kishte mbetur i vrarë viktima B. Sh. dhe i plagosur i dëmtuari V. K., ndërsa në largim e sipër nga vendi i ngjarjes, me dy armët që i mbante në duar përpjetë ka vazhduar të gjuaj në drejtime të ndryshme brenda lokalit dhe me këtë rast me një predhë e ka goditur të dëmtuarën A.B. në anën e pasme të djathtë të humerusit e cila ishte në katin e dytë. Dëshmitarët Z.Z., B. H., V. T. kanë dëshmuar se personi me dy armë kishte gjuajtur në drejtim të V. K. dhe cak i sulmit ishte V. (L...). Dëshmitarët B. Sh.dhe A.B., kanë dëshmuar se viktima B.Sh., para ngjarjes kritike nuk kishte pasur asnjë problem me askënd. Dëshmitari Xh. K. ka dëshmuar se jam i sigurt që personi që kishte gjuajtur me armë ishte G.E, duke theksuar se: *“Po jam i sigurt ngase për mua s’ka kush tjetër ngase nuk kemi pasur problem me askënd tjetër”*.

Derisa largohej nga diskoteka i akuzuari i cili kishte në duar dy armë dhe po gjuante përpjetë, të njëjtin e kishte fokusuar dhe përcjellur nga brenda diskotekës, i dëmtuari H. B. - zyrtar policor, i cili nuk ishte në detyrë zyrtare atë natë, por ishte si mysafir në diskotekë, ashtu që kishte filluar t’u ndjek të akuzuarin nga brenda dhe jashtë diskotekës, i cili po ikte në rrugët e cekura si në pikën II. të dispozitivit të këtij aktgjykimit, dhe derisa po ikte për t’iu liruar rruga nga qytetarët kishte gjuajtur dy here në ajër, dhe pasatj kur i dëmtuari i kishte dhënë urdhrin *“Ndalo Policia!”*,

i akuzuari kishte gjuajtur dy herë në drejtim të tij, ashtu që të dëmtuarin H. B., e kishte qëlluar në pjesën e epërme të regjionit femoral të këmbës së djathtë dhe i njëjti ishte ndalur i plagosur tek Foto “Vali”, ndërsa i akuzuari ka vazhduar të ikë në drejtim të “Raiffeisen Bank”. Derisa i akuzuari po ike nga diskoteka, e kishin ndjekur edhe dëshmitarët Xh.K., K. H. dhe A. B.. Pasi që për rastin ishin njoftuar Policia e Kosovës - Njësia Hetimore Regjionale në Pejë, të njëjtit kishin dalur në vendet e ngjarjes dhe kishin bërë sigurimin e vendeve të ngjarjes, mbledhjen e provave dhe kishin marrë në pyetje dëshmitarët që ishin prezentë në diskotekë atë natë për t’u identifikuar kryesin e veprës penale, përkatësisht personin që kishte gjuajtur me armë në diskotekë. Gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarëve nga ana e zyrtarëve policor, dëshmitari E.O., pas prezantimit të disa fotografive që i’u kishin bërë policia, ishte ndalur tek fotografia e Sh. H., si person i mundshëm që ka mundur të jetë personi që kishte gjuajtur me armë atë natë në diskotekë. Pas kësaj zyrtarët policorë R. M., Sh. B., N. G., L. L. dhe A. Z., sipas urdhrit të Prokurorit të rastit, janë nisur për të shkuar në fshatin Ramun, Komuna e Pejës, tek shtëpia e T. H., në kërkim të personit të dyshuar, pasi që Sh. H. ishte djali i T.H.. Dëshmitarët - zyrtarë policor, Riza Mahaj dhe Shpend Berisha, kanë dëshmuar se pasi që kishin shkuar tek shtëpia e T. H., i njëjti ju kishte hapur derën policëve dhe ata e kishin pyetur për djalin e tij Sh.. T. H. ju kishte thënë zyrtarëve policor se Sh. gjendej në Zvicër, ashtu që me lejen e T. H., zyrtarët policorë kishin hyrë në shtëpinë e T.vetëm për të verifikuar se a gjendej Sh. në shtëpi. Zyrtarët policor aty e gjetën të akuzuarin G. E., të ulur në njërin nga shtretërit, i cili dukej i shqetësuar. Meqenëse i njëjti i është dukur i shqetësuar, zyrtari policor Shpend Berisha e kishte ngritur jastëkun në shtratin ku kishte qenë duke fjetur G. dhe e kishte parë një revole. Të akuzuarin atë natë e kishin shoqëruar në polici për t’u intervistuar. Me datën 03.01.2010, i akuzuari G. E., kishte dhënë deklaratë pranë Stacionit Policor në Pejë dhe kishte nënshkruar listën e armëve të konfiskuara, me numër 2010-DA-019, e oficerit Riza Mahaj, me numër të ID #5661, të datës 03.01.2010, në ora 03:30/h, ku ndaj tij ishte sekuestruar arma e llojit “Sig Sauer”, e kalibrit 9 mm, me numër serik: U 421 774, si dhe dhjetë (10) fishekë të kalibrit 9 mm, ashtu që i njëjti sipas urdhrit të prokurorit të çështjes ishte liruar atë natë.

Këto janë fakte që kanë të bëjnë me ngjarjen që ka ndodhur natën kritike që ka rezultuar me vrasjen e të ndjerit B. Sh., plagosjen e V.K., A. Ba. dhe H. B., të cilat u konfirmuan nga të dy palët por në variante të ndryshme.

Kolegji Penal i Gjykatës se Apelit vlerëson se me provat e administruara vërtetohet se ngjarja kritike kishte ndodhur në Pejë dhe se i akuzuari ishte personi që kishte hyrë në diskotekën "C.. C..", e cila gjendej në afërsi të sheshit "Haxhi Zeka", ku ishin të pranishëm rreth njëmijë (1000)

persona, ashtu që i akuzuari kishte nxjerr dy armë, një revole me ngjyrë të zezë ndërkaq tjetra revole me ngjyrë të bronzit dhe në afërsi të binës që ishte në diskotekë, me dashje dhe në shenjë hakmarrje për t'a privuar nga jeta të dëmtuarin V. K., ka filluar të gjuaj në drejtim të tij i cili ishte në binë duke biseduar në afërsi me viktimën B. Sh., me ç'rast me dashje eventuale ka privuar nga jeta edhe viktimën B., i cili nga gjuajtjet që kishte bërë i akuzuari, i njëjti ishte goditur me një predhë në gjoks e cila i ka shkaktuar vdekjen e menjëhershme, ndërsa V. K. kishte mbetur i plagosur nga goditja me një predhë në gjoks. I akuzuari në largim e sipër nga vendi i ngjarjes, me dy armët që i mbante në duar përpjetë ka vazhduar të gjuaj në drejtime të ndryshme brenda lokalit, dhe me këtë rast me një predhë e ka goditur të dëmtuarën A. B. i në anën e pasme të djathtë të humerusit, duke i shkaktuar lëndime të rënda trupore, dhe me të shtënkat ka vënë në rrezik një numër të madh të personave që ishin duke festuar festën e Vitit të Ri në diskotekë.

Faktin se i akuzuari me dy armë kishte hyrë në diskotekën "...." në Pejë, ku ishin të pranishëm rreth njëmijë (1000) persona, e vërtetojnë të gjithë dëshmitarët të cilët kanë qenë të pranishëm natën kritike në diskotekë.

Po ashtu nuk ka qenë kontestuese se i akuzuari kishte gjuajtur në drejtim të binës ku ishin duke qëndruar i dëmtuari V. K. dhe viktima B. Sh., ngase kjo vërtetohet nga dëshmitë e dëshmitarëve por edhe dëshmitë balisitike përkatësisht gëzhhojat që janë gjendur rreth binës së diskotekës që mund të shihen në skicën e vendit të ngjarjes.

Kolegji penal gjen se me provat e administruara vërtetohet se dashja ishte për t'a privuar nga jeta të dëmtuarin V. K., ky fakt është vërtetuar nga dëshmia e dëshmitarit Z. Z., i cili gjatë shqyrtimit gjyqësor e ka pohuar deklaratën e dhënë në polici të datës 03.01.2010, në të cilën kishte deklaruar se: *"...kam parë se i dyshuari i kishte dy revole në drejtim të L. K. (V. K.) dhe menjëherë i ka kthyer kah Kaqa duke shti në drejtim të tyre"*. Ky fakt vërtetohet edhe nga dëshmia e dëshmitarit B. H. gjatë dëshmimeve të tij të dhëna në Stacionin Policorë në Pejë por edhe në Prokurorinë e Qarkut në Pejë, ku ka deklaruar se *"Natën kritike i dyshuari ka shtënë në drejtim të personit të quajtur "L.", ...të shtënkat në drejtim të tij i ka bërë me dy revole ku njëra revole ka pasur ngjyrë të bronzet, ndërsa tjetra ngjyrë të zezë. I dyshimti për mua ka qenë tërësisht i panjohur. Atë natë me sa kam mundur të perceptoj cak i sulmit ka qenë personi i quajtur "L.", sepse sa kam qenë në dijeni tani i ndjeri B. Sh. - "K.", nuk ka pasur probleme me dikë"*. Po ashtu edhe dëshmitari V. T. në deklaratën e dhënë në polici kishte theksuar se *"cak i gjuajtjes ka qenë L. K., për të tjerët nuk e di"*. Edhe e dëmtuara A.B. gjatë deklarimit të saj në Prokurorinë Themelore në Pejë,



kishte deklaruar se: *“Nuk e njoh G. E., por sipas informatave, qëllimi i tij atë natë kishte qenë për ta privuar nga jeta Valdet Kelmendin nga Peja”.*

Se qëllimi i të akuzuarit ishte për ta privuar nga jeta të dëmtuarin V. K. dhe se i ndjeri B.Sh.ishte privuar nga jeta si rezultat i asaj që ishte në afërsi me V., pra me dashje eventuale dhe se i ndjeri ishte viktimë në këtë rast, vërtetohet edhe nga dëshmia e dëshmitarit B. Sh., vëllait të viktimës B., i cili gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se: *“Sipas fjalëve që janë folur dhe që fliten, familja Kelmendi dhe familja E., edhe para rastit kanë pasur raporte të këqija. Ne kemi qenë viktimë dhe si familje me asnjërën nga këto dy familje që ceka më lartë dhe asnjë familje tjetër nuk kemi pasur ndonjë problem... B. dhe ne si familje nuk kemi pasur telashe me askënd”.* Po ashtu edhe dëshmitari A. B.j, shoku i viktimës B., të cilët ishin bashkëpronar në diskotekën “City Club”, gjatë deklaratës së dhënë në polici kishte deklaruar se *“Jam shumë i sigurt se “K..” nuk ka pasur ndonjë mosmarrëveshje me ndokënd dhe as unë... ne nuk kemi pasur mosmarrëveshje me askënd as në lidhje me lokalitë e as të ndonjë natyre tjetër dhe nuk e besoj se ne kemi mundur t'i pengojmë dikujt dhe mendoj se "K.a" ka qenë vetëm viktimë e rastit”.* Gjithashtu siç është theksuar edhe më lartë edhe dëshmitari B.H. i cili në stacionin policor kishte deklaruar se *“...sa kam qenë në dijeni tani i ndjeri B. Sh.- “K.”, nuk ka pasur probleme me dikë”.* Pra në këtë drejtim vërtetohet fakti se i ndjeri B.t Sh., nuk kishte pasur ndonjë problem para se të ndodhte rasti me ndokënd, asnjë dëshmitar nuk e ka përmendur ndonjë fakt apo rrethanë që ai ishte cak i sulmit nga ana e të akuzuarit me armë atë natë.

Se shkak i gjuajtjes me armë që kishte bërë i akuzuari në drejtimin ku ishte edhe viktima dhe si rezultat i kësaj gjuajtje një predhë e kishte goditur e cila i kishte shkaktuar vdekjen e menjëhershme të ndjerit B. Sh., vërtetohet nga raporti për persona të zhdukur dhe mjekësi ligjore, nga e cila vërtetohet se *“vdekja e B. Sh. ishte si shkak i lëndimeve nga arma e zjarrit në gjoks, duke shpuar zemrën dhe veshkat, duke shkaktuar hemoragji të rënda, në kombinim me lëndimin nga arma e zjarrit në krahun e majtë, ku është gjetur plumbi”.*

Andaj, nga e lartë cekura, kjo Gjykatë në rastin konkret vërteton se sa i përket privimit nga jeta e të ndjerit B. Sh., në veprimet e të akuzuarit kemi të bëjmë më dashje eventuale, sepse i akuzuari ka qenë i vetëdijshëm se mund të shkaktoheshin pasoja si rezultat i veprimeve të tij, duke marrë për bazë që i ndjeri ishte në afërsi me V. K., ku me ç’rast ka mbetur i privuar edhe i ndjeri B.t Sh..

Fakti se i akuzuari deri sa po largohej nga diskoteka kishte gjuajtur në drejtime të ndryshme dhe me këtë rast nga gjuajtjet e tij ishte plagosur edhe e dëmtuara A.Ba., vërtetohet edhe nga dëshmia

e dëshmitarit V. T., e dhënë në Stacionin Policor në Pejë, i cili kishte deklaruar se: “...kam pare personin e armatosur (të dyshuarin) duke mbajtur armë në dy duar, në një dorë ka qene revolja ngjyre e bardhë, ndërsa në dorën tjetër ngjyrë e zezë, ku atë kohë i dyshuari ishte duke shikuar teposhtë, papritmas pasi që më vëren mua në këmbë me një shikim të ashpër pa e ngriture edhe shumë kokën ka gjuajtur në drejtimin tim, e që aty afër e kisha edhe një vajzë të pa njohur, në atë momente kam dëgjuare një britmë të madhe nga ajo vajzë. Në atë kohë jam ulur në shkallë ku kam dëgjuar vetëm britma të njerëzve. Pastaj kam mbetë ulur në shkallë nga stresi që s’kam mundur me të vërejtë asgjë”. Edhe e dëmtuara A. B. gjatë deklaratës të dhënë në Prokurorinë e Qarkut në Pejë, kishte deklaruar se: “Gjersa isha duke vallëzuar kam dëgjuar disa krisma, por për momentin kam menduar se ato janë petarde nga se edhe para pak kohe petardet në fjalë u ndezën nga personeli i restorantit, ashtu që për momentin kam vërejtur se isha e goditur nga prapa me plumb në kraharorin e djathtë, kam vërejtur se filloj të më rrjedh gjak”. Nga raportit i Spitalit Rajonal në Pejë - fletë lëshimi i A. B., vërtetohet se e dëmtuara kishte qëndruara në spital prej datës 02.01.2010 deri me datën 08.01.2010, në këtë spital e dëmtuara kishte shkuar në urgjencën e spitalit si rast i plagosjes me armë zjarri, në regjionin e humerusit të djathtë të pjesës së pasme. Gjatë operimit, në trupin e saj është gjetur një trup metalik, i cili vërehet që është i deformuar me mundësi të mëdha për shkolitje të fragmenteve të vogla metalike nga pjesët e tij. Edhe nga dëshmia e evidentuar si dëshmia #40, vërtetohet se është një predhë e marr nga trupi i viktimës A. B., e cila dëshmi është e dëmtuar por është pjesë e fishekut të kalibrit 7.62x25mm, ku për shkak të dëmtimeve të pësuar gjatë goditjes ka humbur karakteristikat balistike të nevojshme për ekzaminim. Nga të lartëcekurat vërtetohet se me gjuajtjet me armë që kishte bërë i akuzuari brenda diskotekës kishte mbetur e plagosur edhe e dëmtuara A. B., e cila kishte pësuar lëndime të rënda trupore edhe po ashtu i akuzuari kishte vë në rrezik edhe jetën e personave që ishin të pranishëm brenda në diskotekë të cilët natën kritike ishin duke festuar festën e Vitit të Ri.

Fakti se i akuzuari G. E. ishte personi që kishte gjuajtur brenda lokalit në drejtim të dëmtuarit V. K. dhe viktimës B.Sh. dhe kishte gjuajtur në drejtime të ndryshme brenda lokalit dhe me këtë rast me një predhë e ka goditur të dëmtuarën A. B., ndërsa jashtë lokalit, kishte gjuajtur deri sa po ikte edhe në drejtim të dëmtuarit H. B. i cili ishte duke e ndjekur nga pas, është vërtetuar nga provat të cilat do të elaborohen në vijim:

Dëshmitari - i dëmtuari H. B., gjatë shqyrtimit gjyqësor në gjykatën e shkallës së parë ka deklaruar se: “..kur e pashë se janë rrëzuar personat, nga aty kam parë që ka dal një person, ka

*hipur në binë dhe se i njëjti me dy armë që i mbante në duar ka shtënë përpjete, atëherë të gjithë mysafirët janë ulur dhe shtrirë për tokë, personalisht jam ulur në pozitën që i them “cuc” dhe jam munduar t’a identifikoj këtë person të cilin nuk e kisha më larg se 3-4 metra dhe i njëjti gjendej në binën e këngëtarit. Ky person e ka pasur kapelën e vendosur ajo i ka mundësuar që mos t’i shihet fytyra. Pastaj personi ka filluar që të dal nga lokali dhe mendova se i kishte të hargjuar fishekët dhe kam bërë përpkje që ta zë, aty gjatë daljes në korridore të diskotekës ku të gjithë ishin të shtrirë, të shtrirë ishin edhe sigurimi, i dyshuari ka marr në thua dhe ka shkuar duke u zvarritur për muri dhe gati është rrëzuar. Personi duke u larguar ka shtënë edhe njëherë në dalje të diskotekës dhe normal është larguar me fytyrë përpara daljes. Pastaj kur kam dal jashtë, menjëherë e kam nxjerr revolen time e kam futur plumbin në tytë dhe i’u kam vërsulur prapa trotuarit nga sheshi, kah gjendet sheshi “Ardian Krasniqi”. Aty personit në fjalë nuk kam mundur ti jap komandë verbale sepse ishte një numër i madh i qytetarëve duke lëvizur në shesh, pra trotuarit, ashtu që i dyshuari aty ka shtënë në ajër - përpjete sërish me qëllim që t’i lirohet rruga. Pastaj i dyshuari përballë shtatores së “Ardian Krasniqi”, e ka kaluar rrugën në drejtim të lokalit “Muko” dhe aty kam qenë në një distancë me të dyshuarin jo më larg se 4 metra, i’u kam drejtuar me fjalët “ndalo policia”, ku i dyshuari e ka kthyer dorën e majtë mbrapa dhe ka shtënë në drejtim timin. Kam vazhduar sërish t’a ndjek prapa tij dhe i’u kam drejtuar me fjalët “ndalë policia se i’u gjuaj drejtë në kokë”, i dyshuari serish e ka kthyer dorën e majtë dhe ka shtënë në drejtim timin, pastaj aty jam shtangur pasi që më është mpirë trupi dhe kam shtënë edhe unë në drejtim të tij, jo me qëllim t’a vras, por nga frika se mos po më kthehet. Prej që ka dal në binë personi që ka shtënë në ajër dhe derisa jam plagosur ka qenë personi i njëjtë. Nuk kam parë ndonjë person tjetër që ka shtënë në drejtim timin”.*

Pra, nga kjo deklaratë vërtetohet se i dëmtuari Hasan Buçaj – zyrtar policor, i cili ishte jashtë detyrës zyrtare natën kritike, e kishte ndjekur personin që kishte shtënë brenda diskotekës, pra nga brenda deri në momentin kur ishte plagosur i dëmtuari jashtë diskotekës, saktësisht tek foto “Vali” që gjendet në mes të butikut “Muko” dhe hyrjes në drejtim të “Raiffeisen Bank”. Gjithashtu, vërtetohet se i akuzuari me gjuajtjet me armë që i kishte bërë për t’iu liruar rruga nga qytetarët që ishin duke lëvizur në këtë pjesë të qytetit, kishte shkaktuar rrezik të madh për jetën e qytetarëve që po lëviznin. Gjithashtu me gjuajtjet që kishte bërë në drejtim të dëmtuarit Hasan Buçaj, si rezultat i këtyre gjuajtjeve një predhë e kishte goditur të dëmtuarin Hasan Buçaj me ç’rast ka pësuar lëndime të rënda trupore. Nga deklarimi i eksperti mjeko-ligjor Nami Uka, i cili gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se “dëmtimet e përshkruara në raportin mjekësor, fletë lëshimin me epikrizë, të lëshuar nga Spitali Rajonal i Pejës, kualifikohen si dëmtime të rënda

*trupore*". Gjithashtu është vërtetuar se nga arma e cila i është gjetur të akuzuarit nën jastëk natën kritike, përkatësisht arma e llojit "Sig Sauer", model P226, e kalibrit 9x19 mm, me numër serik U 421 774, ishte plagosur i dëmtuari Hasan Buqaj, ngase predha që evidentohet si dëshmia EX#39 që është nxjerr nga trupi i të dëmtuarit Hasan, është vërtetuar se është shkrepur nga pistoleta e lartpërmendur. Kjo është vërtetuar me mendimin e ekspertit të balistikës Ilir Kukaj, i cili ka konstatuar se: plumbi i evidentuar si dëshmia me numër EX#39 (plumbi që është nxjerr nga i dëmtuari H.B.), është shkrepur nga pistoleta "Sig Sauer", model P226, e kalibrit 9x19 mm, me numër serik U421774. Edhe dëshmitari ., gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se: *"në momentin kur jam operuar dhe më është nxjerrë predha nga trupi, e kam kuptuar që ka qenë një armë 9 mm". Gjatë gjykimeve e kam kuptuar në bazë të shkresave të lëndës se ka qenë arma e llojit "Sig Sauer", model P226, por nuk e kam kuptuar se çfarë ngjyre ka pasur*". Prandja, nga të lartpërmendurat gjykata ka vërtetuar se nga gjuajtjet me armën e lartpërmendur që kishte bërë i akuzuari në drejtim të dëmtuarit H.Buqaj, përkatësisht nga predha e armës së tij ishte plagosur këtu i dëmtuari dhe më këtë rast kishte pësuar lëndime të rënda trupore, po ashtu me gjuajtjet jashtë diskotekës që kishte bërë me qëllim që ti lirohej rruga nga qytetaret të cilët po lëviznin në rrugët e qytetit të Pejës natën kritike ka vë në rrezik edhe jetën tyre.

Në vijim kolegji penal do të analizoj se si është vërtetuar identiteti i të akuzuarit G. E., se i njëjti ishte personi që atë natë kishte hyrë në diskotekën "...", dhe kishte gjuajtur me armë në drejtim të të dëmtuarit V. K., viktimës B. Sh. dhe në drejtime të ndryshme ku ka mbetur e plagosur edhe e dëmtuara A. B., dhe po ashtu deri sa po ikte jashtë disokotekës kishte gjuajtur gjatë ikjes edhe në drejtim të dëmtuarit H.B. i cilin po e ndiqte nga pas, dhe si rezultat i gjuajtjes nga ana e të akuzuarit i dëmtuari H.B. kishte mbetur i plagosur.

Fillimisht dëshmitari Xh. K., i cili ka qenë dëshmitar okular dhe ka qenë prezent atë natë në diskotekën ".....", i cili po ashtu e kishte ndjekur të akuzuarin deri sa po ikte jashtë diskotekës, gjatë marrjes në pyetje në polici me datën 22.11.2016, kishte nënshkruar procesverbalin mbi identifikimin e personit përmes fotografisë, ashtu që pas prezentimit të fotografive i njëjti në foton numër 8 e kishte identifikuar personin që kishte shtënë me armë atë natë, e që kjo fotografi ka qenë fotografia e të akuzuarit G. E.. Dëshmitari Xh. K. edhe gjatë dëshmisë së tij gjatë shqyrtimit gjyqësor e ka bërë të njëjtën gjë duke e identifikuar të akuzuarin.

Në këtë drejtim fakti që personi i cili kishte gjuajtur me armë në diskotekën "...", ishte i akuzuari G. E., vërtetohet edhe nga dëshmia e dëshmitarit H. B., të cilit gjykata i'a ka falur besimin për shkak se ka qenë dëshmitarë okular i cili kishte ndjekur personin që kishte shtënë me armë në

diskotekë deri në momentin kur është plagosur vet i dëmtuari H.B.. Po ashtu dëshmia e tij përputhet në tërësi me gjurmët balistike të cilat kanë mbetur si gjurmë nga gjuajtjet që ishin bërë gjatë ikjes nga ana e të akuzuarit në diskotokë dhe jashtë diskotekës. Pra, dëshmia e dëshmitarit H. B., përputhet në tërësi edhe me raportin e këqyrjes së vendit të ngjarjes, me numër FRP-10-002, i datës 11.01.2010, përkatësisht me skicën brenda diskotekës dhe me skicën nr.1, jashtë diskotekës, si dhe me mendimin e ekspertit të balistikës Ilir Kukaj, ashtu që në vijim gjykata do të analizojë deklaratën e të dëmtuarit H. B. lidhur me lidhmërinë e secilës gjurmë balistike të cekura në provat e lartpërmendura që vërtetojnë që personi që kishte shtënë me armë ka qenë i akuzuari G. E..

Dëshmitari H.B., i cili ishte zyrtar policor jashtë detyrës, gjatë dëshmisë së tij ka deklaruar se e kishte në fokus - përcjellje personin prej momenti që kishte dal në binë me dy armët në duar, pra ka deklaruar se; *“prej që ka dalë në binë personi që ka shtënë me armë në ajër brenda në diskotekë derisa jam plagosur, ka qenë personi i njëjtë të cilin e kam ndjekur në një distancë deri në 4 metra, jo më larg”*. Pra nga kjo vërtetohet se dëshmitari e kishte nën fokus dhe përcjellje personin gjatë gjithë kohës prej momentit kur e kishte parë në binë në diskotekë, deri kur ishte plagosur vet i dëmtuari H. B., jashtë diskotekës.

Dëshmitari H. B., po ashtu ka deklaruar se: *“Personi duke u larguar ka shtënë edhe njëherë në dalje të diskotekës”*. Ky fakt vërtetohet edhe nga dëshmia e dëshmitares B. S., e cila ka punuar jashtë diskotekës në arkë ku paguheshin biletat për hyrje, e cila po ashtu ka deklaruar se: *“kur kanë filluar njerëzit të dalin jashtë kam dëgjuar një krismë jashtë dhe kam mbetur pa koment”*. Nga raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes, me numër FRP-10-002, i datës 11.01.2010, përkatësisht skicës nr.1, vërtetohet se para lokalit në dalje të diskotekës është gjetur një gëzhojë e kalibrit 7.62x25 mm, e cila është evidentuar si dëshmia EX#1, e që vërtetohet se ishte gjuajtja që është bërë nga i akuzuari në dalje të diskotekës, të cilin fakt e vërtetojnë edhe dëshmitarët e lartë përmendur.

Në vazhdim, dëshmitari H. B. ka deklaruar se: *“pasi kam dal në trotuar personi ka shtënë me armë ndërmjet shtatores së “Ardian Krasniqit” dhe diskotekës “....”, dhe këto të shtëna i ka bërë për t’iu liruar rruga derisa ai ishte në ikje dhe në këtë pjesë ka shtënë 2 (dy) herë”*. Edhe ky deklaram i dëshmitarit është në harmoni me raportin e këqyrjes së vendit të ngjarjes me numër FRP-10-002, i datës 11.01.2010, përkatësisht skicës nr.1, ngase për 2 (dy) gjuajtjet të cilat i përmend dëshmitari, vërtetohet se në këtë pjesë janë gjetur si prova gjurmët balistike, përkatësisht 2 (dy) gëzhoja, dhe atë: 1 (një) gëzhøjë e kalibrit 9x19 mm, e cila është evidentuar

si dëshmia EX#7 dhe gjithashtu është gjetur edhe 1 (një) gëzhojë e kalibrit 7.62x25 mm, e cila është evidentuar si dëshmia EX#5.

Gjithashtu dëshmitari H.B. në vazhdim ka sqaruar se: *“Ndërsa 2 (dy) herë të tjera ka shtënë në drejtim timin me dorën e majtë, kur kam dhënë komandat verbale ”ndalo”, që i bie që i njëjti ka gjuajtur 4 (katër) herë edhe me gjuajtjet e lartë përmendura”*. Pra, edhe ky deklaram i dëshmitarit është në harmoni me raportin e këqyrjes së vendit të ngjarjes me numër FRP-10-002, i datës 11.01.2010, përkatësisht skicës nr.1, ngase për 2 (dy) gjuajtjet që përmend dëshmitari vërtetohet se në këtë pjesë janë gjetur si prova gjurmët balisike, përaktësisht 2 (dy) gëzhjoja të kalibrit 9x19 mm, të cilat janë evidentuar si dëshmia EX#2 dhe EX#3.

Nga përshkrimi i deklaramit të dëshmitarit të lartpërmendur dhe gjurmëve balisitike përkatësisht gëzhjojave, vërtetohet se i akuzuari natën kritike kishte përdorur dy armë brenda diskotekës ato të kalibrit 7.62x25 mm, ashtu që njëri prej këtyre dy armëve e kishte përdorur edhe gjatë ikjes përderisa po e ndiqte dëshmitari H. B., ngase kjo vërtetohet nga dëshmia përkatësisht gëzhjojat kalibrit 7.62x25 mm që janë evidentuar si dëshmia: EX#1 dhe EX#5, që përputhen me gëzhjojat përaktësisht dëshmitë e evidentuar me shifrat EX#15, EX#16, EX#17, EX#18, të cilat janë gjetur brenda diskotekës. Gjithashtu i akuzuari gjatë ikjes e kishte përdorur edhe armën e llojit: *“Sig Sauer”*, model P226, e kalibrit 9x19 mm, me numër serik U 421 774, ngase kjo vërtetohet edhe nga gjurmët balisitke, përkatësisht gëzhjojat që janë gjetur në vendet siç i ka përshkruar dëshmitari H. B., ngase në këto pjesë janë gjetur gëzhjojat e kalibrit 9x19 mm që janë evidentuar si dëshmia: EX#2, EX#3, EX#7, që të tri këto gëzhjoja kanë lidhmëri me predhën e fishekut të kësaj armë e cila është nxjerrur nga trupi i të dëmtuari H. B. që është evidentuar si predhë e kalibrit 9x19 mm, e evidentuar si dëshmia: EX#39.

Në këtë drejtim dëshmia e dëshmitarit H. B. dhe Raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes, janë në harmoni edhe me mendimin e ekspertit Ilir Kukaj, i cili gjatë shqyrtimit gjyqësor lidhur me armët që janë përdorur brenda dhe jashtë diskotekës ka deklaruar se: *“Gëzhjojat e evidentuara me shifrën EX#1, EX#5, të cilat janë gjetur jashtë janë shkrepur nga e njëjta armë, me gëzhjojat e shkrepura brenda lokalit dhe që janë evidentuar me shifrat EX#15, EX#16, EX#17, EX#18, pra kemi të bëjmë me dy gëzhjoja jashtë lokalit dhe katër gëzhjoja brenda lokalit, pra të shkrepura nga e njëjta armë..”*. Gjithashtu eksperti Ilir Kukaj, ka konstatuar se tri gëzhjoja të evidentuara me numër EX#2, EX#3, EX#7 dhe një plumb i evidentuar me numër EX#39 (plumbi që është nxjerr nga i dëmtuari H. B.), janë shkrepur nga pistoleta *“Sig Sauer”*, model P226, e kalibrit 9x19

mm, me numër serik U421774, dhe rezulton se prej kësaj arme janë shkrepur të gjitha pjesët e fishekëve të kalibrit 9x19 mm.

Kolegji vëren se gjykata shkallës së parë duke vepruar sipas rekomandimit të Gjykatës Supreme në rigjykim ka dëgjuar prapë ekspertin Ilir Kukaj i cili në detaje ka sqaruar se arma e llojit “Sig Sauer”, e ekzaminuar, përputhet me dëshminë numër 7 (gëzhoja) i përket revoles të llojit "Sig Sauer", model P 226, kalibër 9x19 mm, me nr. serik U421774, si dhe një plumb i evidentuar EX39, që është nxjerr nga trupi i zyrtarit policor Hasan Buqaj.

Nga të lartpërmendurat vërtetohet se i akuzuari kur kishte gjuajtur me armën e kalibrit 7.62x25 mm para diskotekës që është gjetur gëzhoja e evidentuar si dëshmisë EX#1 dhe afër sheshit “Ardian Krasniqi” që është gjetur gëzhoja e evidentuar si dëshmia EX#5, me çka vërtetohet se i akuzuari kishte përdorur të njëjtën armë brenda lokalit dhe jashtë lokalit gjatë ikjes përderisa po e ndiqte i dëmtuari H. B., ngase edhe kjo evidentohet sipas gjurmëve balistike përkatësisht gëzhojave të lartpërmendura. Gjithashtu vërtetohet se i akuzuari gjatë ikjes e kishte përdorur edhe armën e cila i është gjetur të akuzuarit nën jastëk natën kritike, ngase me armën e llojit: “Sig Sauer”, model P226, e kalibrit 9x19 mm, me numër serik U 421 774, është plagosur i dëmtuari H. B.. Ky fakt vërtetohet ngase predha që evidentohet si dëshmia EX#39 që është nxjerr nga trupi i të dëmtuarit H. B., është shkrepur nga pistoleta e lartpërmendur dhe kjo përputhet edhe me deklarimin e dëshmitarit H. B., i cili po ashtu gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se *“në momentin kur jam operuar, më është nxjerrë predha nga trupi, e kam kuptuar që ka qenë një armë 9 mm”. Gjatë gjykimeve e kam kuptuar në bazë të shkresave të lëndës se ka qenë arma e llojit “Sig Sauer”, model P226, por nuk e kam kuptuar se çfarë ngjyre ka pasur”.*

Nga dëshmitë e gjithë dëshmitarëve është vërtetuar se natën kritike për brenda diskotekës nuk kishin parë persona të tjerë që kishin gjuajtur me armë atë natë përveç personit të cilin e kishte ndjekur H. Bu. për derisa ai po ikte.

Gjithashtu personin që kishte gjuajtur me armë atë natë brenda diskotekës, e kishin ndjekur edhe dëshmitarët: Xh. K., K. H. dhe A. Bi. dhe kjo vërtetohet nga deklarimet e tyre të dhëna gjatë shqyrtimeve gjyqësore.

Lidhur me dëshmitarët e tjerë të cilët janë pyetur rreth identifikimit të personit që kishte gjuajtur me armë brenda diskotekës “.....” e që shumica kanë deklaruar se ka pasur flokë të errëta, por disa kanë thënë se ka qenë bjond dhe ka pasur floktë e gjata e disa të shkurtëra, se ka qenë i gjatë 1.70 deri 1.90 cm, se ka pasur të veshur xhaketë të mbyllur dhe pantallona xhinse, jakne të

shkurtër, e disa të gjatë dhe në forma të tjera siç e kanë bërë dëshmitarët, gjykata në këtë drejtim vlerëson se përshkrimi në forma të ndryshme nga ana e dëshmitarëve ka ardhur fillimisht si rezultat i ndriqimit të dobët që ishte brenda në diskotekë, e që kjo mund të vërtetohet edhe nga videoinqizimi në CD, nga i cili incizim janë nxjerrë edhe fotografitë me titullin, “*imazhet e qartësuara nga video incizimet*”, të cilat incizime ishin bërë para se të ndodhte rasti kritik në diskotekë. Po ashtu, pothuajse të gjithë dëshmitarët kanë dëshmuar se pasi që i akuzuari kishte filluar me të shtëna në drejtime të ndryshme, nga frika të gjithë pothuajse janë shtrirë për tokë me qëllim që ta mbrojnë vetën sepse kanë qenë të frikësuar dhe të tronditur nga ngjarja. Prandaj, gjykata ka ardhur në përfundim se përshkrimet në forma të ndryshme nga ana e dëshmitarëve lidhur me identifikimin e personit që kishte shtënë me armë brenda diskotekës atë natë ka ardhur si rezultat i arsyeve të lartpërmendura. Andaj, duke marrë për bazë që përshkrimi i tyre del të jetë kontradiktor me njëri tjetrin, gjykata nuk i dha rëndësi vendimtare ngase nga dëshmitë e tyre del se nga frika nuk kishin qëllim identifikimin e personit që po gjuante por mbrojtjen e jetës së tyre, ngase pothuajse të gjithë dëshmitarët kanë deklaruar se në ato momente ishin shtrirë për toke për t’u mbrojtur.

Po ashtu, kolegji penal vlerëson se nga provat e administruara në shqyrtim gjyqësor nga gjykata shkallës së parë vërtetohet fakti se të akuzuarit G. E., natën kritike në fshatin R., Komuna e Pejës, në shtëpinë e T.H. i ishte gjetur, arma e llojit “Sig Saur”, model P226, e kalibrit 9x19mm, me numër serik U421 774, të cilën armë i akuzuari e mbante në posedim në kundërshtim me Ligjin për Armët, pra nuk kishte leje të veçante që ta mbante në posedim apo kontroll, armën e cila i ishte gjetur nën jastëkun ku ishte duke fjetur i akuzuari. Ky fakt është vërtetuar nga dëshmia e dëshmitarit Sh.B. i cili gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se: “*...në katin e parë ka qenë T. H.me G.. Në atë kohë, ndoshta edhe pse ka qenë kohë pa kohë, kur kemi hyrë, G. ka qenë i shqetësuar. E kam pyetur T., se pse po shqetësohet kaq shumë ky djalë, më ka tregu se ka pas një rast ku ka qenë prezent ku i është vra vëllai dhe kanë gjuajtur në të, prandaj është më i shqetësuar. Ne vetëm ishim në përfundim dhe e kemi pyetur T. se ku keni qenë duke fjet dhe më ka treguar shtretërit se ku kishin fjetur ai dhe G.i, aty tek dera në dhomë ku kanë fjetë, kanë qenë Riza me një kolegë dhe dy policë të njësisë speciale, kam menduar se meqenëse frigohet mundet me pas ndonjë mjet për tu mbrojtur, e kam ngrit jastëkun ku ka qenë duke fjet G. dhe e kam parë një revole e cila ka qenë në shtratin në të cilin G. kishte qenë duke fjetur. E kam pyetur G.n se e kujt është arma, më ka thënë se sot duke ardhur rrugës tek T. e kam gjet në livadhe. Arma ka qenë “Sig Sauer”. Edhe dëshmitari Riza Mahaj gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se: “Shpendi kur ka hyrë në njërën prej dhomave më ka thirrë dhe më ka thënë se është një armë*



*zjarri, kam hy në atë dhomë, aty kishin qenë dy shtretër të shtruar dhe në njërin jastëk përfundi tij, ka qenë një revole, kemi marr revolen, kemi marr dy personat që kanë qenë aty, përkatësisht E. dhe G.dhe të njëjtit i kemi dërguar në Stacionin Policor në Pejë. Revolen e kemi gjetur nën jastëkun e njërit prej shtretërve, ngase toger Shpendi ka hy në atë dhomë dhe ai e ka pa se kush dhe ku ka qenë ratë, pra duke fjetur. Sipas Shpendit arma ka qenë “Sig Sauer.”*

Sa i përket çështjes lidhur me veprimet e policisë me rastin e hyrjes në shtëpinë e T. H. kolegji vlerëson se duke i'u referuar nenit 245 par. 1, nënpar. 3 të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës i cili ka qenë në fuqi në atë kohë, kur është e domosdoshme dhe në masë të nevojshme, policia mund të hyjë në shtëpinë dhe lokalet tjera të personit dhe të zbatojë kontrollin pa urdhrin e gjyqtarit të procedurës paraprake nëse kryerësi i kapur në flagrancë gjatë kryerjes së veprës penale duhet arrestuar pas ndjekjes. Në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me kontrollë të shtëpisë dhe objekteve përcjellëse por zyrtarët policorë kanë vepruar në kërkim të personit të dyshuar atëherë Sh. H. dhe se me pëlqimin e pronarit të shtëpisë kanë hyrë në shtëpi dhe me atë rast kanë hasur në të akuzuarin G.E.i cili nën jastek në shtratin ku ishte duke fjetur kishte pasë armën e llojit “Sig Sauer”, të përshkruar si në raport policor e që edhe pas ekzaminimit nga ana e ekspertit të balistikës ka rezultuar se e njëjta është përdorë në plagosjen e të dëmtuarit - zyrtarit policor, Hasan Buqaj. Për më tepër për këtë çështje kolegji gjen se është vendosur me aktvendim të veçantë dhe të arsyetuar nga ana e Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti për Krime të Rënda, numër PKR.nr.253/2016, të datës 23.01.2017, i cili aktvendim është bërë i plotfuqishëm, pra, është vërtetuar nga Gjykata Apelit e Kosovës, me aktvendimin, PN.nr.252/2018, të datës 30.032018.

Gjykata Apelit nga provat të cilat janë administruar në shqyrtimin gjyqësor, pas vlerësimit dhe analizimit të tyre një nga një, e pastaj në lidhje me njëra tjetrën, ka ardhur në përfundim se nuk mund t'i falet besimi mbrojtjes së të akuzuarit G. E., të dhënë gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor në gjykatën e shkallës së parë ku e mohon kryerjen e veprave penale ngase sipas vlerësimit të kësaj Gjykate kjo është bërë thjeshtë me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale dhe se mbrojtja e tij është në kundërshtim me të gjitha provat të cilat janë administruar në shqyrtim gjyqësor nga gjykata shkallës së parë e të cilave kjo Gjykatë u falë besimin, se mbrojtja e të akuzuarit pjesërisht është në kundërshtim edhe me vet deklaratën e tij të dhënë në Stacionin Policorë në Pejë.

Gjykata Apelit ka vlerësuar dhe analizuar mbrojtjen e të akuzuarit G. E., të dhënë në gjykatën e shkallës së parë i cili ka deklaruar se: *“Kam dëgjuar akuzën e prokurorit që thotë se kam qenë*

*në diskotekë dhe kam vrarë dike, vetëm dua të theksoi se jo vetëm aty por edhe çka ka bar-lokale të natës në Pejë kurrë nuk jam dal. Diskotekën “City Club”, nuk e kam ditur”, kolegji konsideron se ky deklaram i tij është në kundërshtim me provat të cilat janë elaboruar gjatë arsyetimit lidhur me identifikimin e personit që kishte shtënë me armë brenda dhe jashtë diskotekës, e që është vërtetuar se ishte G. E., e që konsideron se janë në kundërshtim me mbrojtjen e të akuzuarit, prandaj kolegji nuk do të lëshohet në arsyetim të serishëm të këtij fakti.*

Gjithashtu i akuzuari ka deklaruar se: *“tek halla Zojë, kam shkuar në fshatin Ramun, sepse pata ba be me shku tek halla se nuk kam qenë një kohë të gjatë dhe ka pasur një aksident djali i hallës T.H., dhe po ashtu që kam pasur të shkoi në mëngjes me marr autobusin ngase e kanë pasur shtëpinë afër rrugës për me shku për Prishtinë, dhe kam pas për me shku për Serbi me i rregulluar dokumentet. Të nesërmen në mëngjes jemi zgjuar dhe kemi pi kafe. T. më ka përcjellë deri tek rruga për me hip në autobus për me shku në Prishtinë, aty jemi ndarë me T. dhe kam vazhduar rrugën për Prishtinë dhe pastaj për në Kragujevcë.”* Ky deklaram i të akuzuarit se kinse kishte shkuar me qëllim që ta marr më afër autobusin dhe të nesërmen e kishte përcjell T. deri tek rruga ku hipet në autobusë dhe kishte vazhduar për Prishtinë, është tërësisht në kundërshtim me deklaratën e dëshmitarit T. H., i cili gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se: *“Kur jemi zgjuar, G. ka qenë ende në shtëpinë tonë, nuk ka vazhduar me ndejt edhe atë ditë ka shkuar në shtëpinë e tij, e kam përcjell deri tek rruga, përkatësisht deri tek pompa e “Shalës”, deri aty kemi shkuar në këmbë”*. Pra nuk del se i akuzuari kishte shkuar për në Prishtinë, por i akuzuari ishte kthyer në shtëpinë e tij.

Po ashtu i akuzuari ka deklaruar se: *“Kur kemi dal prej shpije e kam marrë armën me vete se kemi pasur shumë raste, ngase ma kanë vra babën dhe vëllain në atë kohë dhe prej kohës kur jam plagosë, nuk kam pasur shumë marak me u afruar me armët, e di që S. kur është nisur me shku më ka thënë se pasi po shkon te halla merre me veti edhe ashtu është e vogël mundesh me e shti në xhep, bile pasi po shkon vetëm merre me veti. Armën kam pas me i’a lan T., e Tahiri kur të ketë kohe ka pas me e kthy në katund në shtëpinë time”*. Po ashtu, ky deklaram i të akuzuarit është përsëri në tërësi në kundërshtim me deklaratën e dëshmitarit T.H., i cili ka deklaruar se: *“Armën nuk e kam parë asnjëherë. Nuk më kujtohet a na kanë pyetur policia e kujt është arma, e di që është thënë se është gjetur ku ka qenë G.. Ka shtuar se atë natë G. nuk më ka treguar që ka armë me vete”*. Nga kjo del se dëshmitari T.H. fare nuk kishte dijeni se atë natë i akuzuari G. kishte armën me vete, e aq më shumë që i akuzuari armën kishte për t’ia lënë atij që ta kthente në shtëpinë e G. E..

Gjithashtu i akuzuari ka deklaruar se: *“arma ishte “Bereta” që ma kanë gjetur mua dhe jo armën të cilën e kanë pruar në gjykatë në Pejë. Atë natë në polici nuk e kam parë më sy atë armë, arma që më është prezantuar në gjykatën e Pejës “Sig Sauer”, ka qenë më e madhe, bile edhe njëherë më e madhe se arma të cilën ma kanë marr mua nën jastëk. Gjithashtu ky deklaram i të akuzuarit është në kundërshtim me listën e armeve të konfiskuara, me numër 2010-DA-019 të datës 03.01.2010, në ora 03:30, nga cila vërtetohet se nga ana e të akuzuarit G. E. është sekuestruar arma e llojit “Sig Sauer”, e kalibrit 9mm, me numër serik U 421 774, si dhe dhjetë (10) fishekë të kalibrit 9mm, e cila listë është e nënshkruar nga ana e tij. Po ashtu, vet i akuzuari ka konfirmuar se të gjitha nënshkrimet që i kishte bërë gjatë dhënies së deklaratës së tij në Stacionin Policor në Pejë atë natë janë të tij dhe e kishte pranuar se arma e lartpërmendur e cila ishte sekuestruar nga ana e policisë ishte e tij. Prandaj, kolegji penal konsideron se mbrojtja e të akuzuarit, duke e mohuar kryerjen e veprave penale për të cilat akuzohet është bërë me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale, për shkak se arma e cila i është gjetur nën jastëk atij ishte njëra prej armëve që e kish përdorur i akuzuari natën kritik, e të cilat fakte janë elaboruar më lartë.*

Kolegji ka analizuar edhe dëshmitë e dëshmitarëve të mbrojtjes dhe atë të dëshmitarit T. Hyseni, R. H., I. H., të cilët kanë qenë të afërm të akuzuarit G. E., ashtu që deklarimi i tyre ka ndryshuar me deklaratat e dhëna më parë në polici, lidhur më kohën e shkuarjes së të akuzuarit në shtëpinë e tyre në fshatin Ramun, Komuna e Pejës, e po ashtu deklaramet e tyre lidhur me këtë fakt nuk kanë përputhshmëri me njëra tjetrën, e po ashtu kanë qenë në sh’përputhje edhe me kohën kur këta dëshmitarë kishin përshkruar shkuarjen tek familja e R. H. në fshatin L..., Komuna e Pejës, si dhe kthimin e tyre. Dëshmitari T. H. në gjykatën e shkallës së parë kishte theksuar se *“tek miku kam shkuar me shoqen time R. dhe djalin E., koha kur kemi shkuar ka qenë rreth orës 21:00/h deri 22:00/h dhe kemi qëndruar një (1) orë”*. Ky deklarimi ka qenë tërësisht në kundërshtim me deklaratën e dëshmitarit T.K., të cilit kolegji i ka falur besimin e i cili ka deklaruar se *“koha kur kishte pasur problem me djalin e T. H., E. dhe e kishte ndjekur me veturë deri në shtëpinë e T. H., (që si ngjarje kishte qenë gjatë kthimit të T.H. nga fshati L. për në shtëpinë e tij), ka qenë rreth orës 20:40/h apo 20:45/h, pra ora 21:00/h nuk ka qenë”*. Dëshmitari T. K. ka shtuar se *“në polici kur kam dhënë deklaratë më kanë thirr policia në telefon dhe i’u kam thënë se çka po doni prej meje, polici më ka thënë se është puna rreth orës, ngase ata kanë thënë se ka qenë ora 23:00, ndërsa ngjarja që kishte ndodhur mes nesh ka qenë rreth orës që kam përcaktuar më lartë dhe për këtë kam pasur dëshmitar”*.

Prandaj deklarata e dëshmitarit T. K. ka përputhshmëri me kohën që kishte përshkruar dëshmitarja R. H. gjatë dhënies së deklaratës fillestare në polici, ku kishte deklaruar se *“rreth*

orës 18:00/h kishin shkuar tek familja e saj dhe kishin qëndruar deri në ora 20:00/h, ndoshta pak më gjatë. Ora ka qenë 21:00/h dhe në atë kohë të gjithë kemi ngrënë darkë së bashku. Deklaroi se gjatë kthimit për në shtëpi jemi ndalur tek pompa e “Shales”, në Ramun, aty djali im E. ka blerë cigare, bile në atë moment djali kishte bërë fjale me disa njerëz për veturën e tyre që e kishin lenë në rrugë, ata njerëz janë nga R., janë të familjes Kabashi”, çka deklarata e kësaj dëshmitare në polici në tërësi përputhet me deklarinimin e T.K.. E njëjta ka vazhduar të theksoj se “pasi që kemi ngrënë darkë, kemi pir çaj, pas një kohe unë isha në katin e dytë dhe vajza ime A. ka ardhur tek unë dhe më tha se ka ardhur G., unë e pyeta se më kënd ka ardhur, ajo më tha e pruni një kerr dhe është vetëm. Nuk më kujtohet koha e saktë. Derisa isha në katin e dytë kam dëgjuar një veturë që ka ardhur shpejt dhe është larguar me të shpejt, sepse kam dëgjuar ushtrimën e veturës...”. Prandaj nëse analizohet deklarata e dëshmitares R. H. lidhur me kohën e ardhjes së G. në shtëpinë e tyre, në raport me deklaratën e Il.H. e cila kishte deklaruar se “G. ka ardhur rreth orës 18:00”, deklaratën e T. H. i cili gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se “G. ka ardhur rreth orës 20:00/h”, si dhe deklaratën e të akuzuarit të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor kur është pyetur nga mbrojtja se “në deklaratën në polici ka thënë se në R. kam mbërri rreth orës 16:00, i akuzuari ka deklaruar se nuk është e saktë ora që kam thënë në polici, se orën nuk e kam këqyrë, si është zakon që kemi thënë në aksham, duke u ba terr rreth akshamit, në atë kohë ka qenë dita e shkurt, ka mund me i ra në atë kohë, por orën nuk e di”, del se këto deklarata janë tërësisht në kundërshtim me njëra tjetrën, prandaj duke marr për bazë se dëshmitarët e mbrojtjes kanë afërsi me të akuzuarin G. E., kolegji deklarimet e tyre i konsideron si të anshme dhe të pabesueshme prandaj edhe nuk ua ka falur besimin.

Sa i përket dëshmitarit F. Sh., kolegji ka analizuar dëshminë e tij dhe ka ardhur në përfundim se dëshmia e tij nuk është e besueshme për faktin se tani raportet me familjen e të ndjerit B.Sh., përkatësisht të dëmtuarin B. Sh. i kanë jo të mira, për shkak të rrethanave që ka përmendur ky dëshmitar dhe po ashtu deklarimi i tij është në kundërshtim edhe me deklarinimin e B. Sh., lidhur me dorëzimin e zarfit ngase ky dëshmitar thekson se K. B. personalisht i’ a kishte dorëzuar B. Sh.dhe ka përmendur edhe emra tjerë të cilët në asnjë fazë nuk i kishte përmendur dëshmitari B. Sh. ngase i njëjti kishte deklaruar se: “K. B. i cili është fqinjë në lagjen ... Zarfin i’ a ka dorëzuar nënës time, në momentin që kam shkuar në shtëpi, nëna ime më ka treguar për zarfin në fjalë, për mua ka qenë zarf i dyshimtë sepse nuk ka pasur prejardhje, pra nuk ka pasur emër dhe mbiemër dhe vetëm personi që e ka dorëzuar K.B., i cili ka qenë komshiu im, në atë moment e kam thirr K., e kam pyetur për prejardhjen e zarfit, i njëjti më ka thënë që zarfin ma kanë dhënë disa shokë të mi, tezak të E.... që jetojnë në Zvicër.

Ndërsa dëshmitari Fl.Sh. ka deklaruar se: *Ka shtuar se Korabi e ka pasur një zarf dhe aty nuk ka pasur shumë të madhe të parave, në atë zarf kanë futur pare secili, pra vullnetar kush ka dashur, aty kanë futur para edhe familja B... me të cilën kishte punuar ai dhe vëllai i viktimës, po ashtu iu ka drejtuar se këto para i kemi mbledh dhe ka kontribuar edhe B. E. dhe B. E., atij kur i është përmend mbiemri e ka refuzuar zarfin dhe ka thënë faleminderit por këtë zarf nuk po du me e marr. Prandaj, duke e marr për bazë që vetë ky dëshmitar ka theksuar se “Tani me B. Sh.nuk flasim për shkak të akuzave që më ka bërë I. F. ndaj meje për këtë rast, kolegji deklarimin e këtij dëshmitari e ka vlerësuar si kontradiktore me vetën dhe jo të besueshme.*

#### Motivi i kryerjes së veprës penale

Kolegji penal i Gjykatës se Apelit sa i përket motivit se i akuzuari ka kryer veprën penale të vrasjes së rëndë në shënjë hakmarrjeje për të privuar nga jeta V.K., këtë fakt e ka vërtetuar duke u bazuar fillimisht në deklaratën e dëshmitarit Xh. K., i cili ka deklaruar se “*nuk ka pas kush tjetër përveç G., nuk kemi pasur problem me askënd tjetër, sepse axhallarët e mi kanë pasur probleme më vëllain e G.dhe ajo ka qenë arsyeja, nuk ka qenë rasti i parë që kanë gjuajtur, por kanë qenë edhe disa raste, është rasti më herët që ka ndodhur në 2006, ditën e bajramit, tek varri i vëllait, ma kanë montuar eksplozivin dhe pas një viti menjëherë më kanë gjuajtur me dy kallasha, ku kam qenë i plagosur unë dhe 3 persona tjerë. Nuk mundem me thënë që i ka bërë G. këto, ngase nuk e kam parë. Sipas meje arsyeja që G. ka qenë sulmuesi në ngjarjen e “City Club”, ka qenë se axhallarët kanë pasur probleme me vëllain e G., s’ka pasur arsye tjetër”.*

Faktin se raportet ndërmjet familjes K. dhe familjes E. kanë qenë të këqija, e vërteton edhe dëshmitari K. H. i cili gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se “*për raportet që kanë pasur L. (V.K.) me familjen E. kam qenë në njohuri, ashtu siç ka qenë i gjithë qyteti i Pejës se nuk kanë pasur raporte të mira, kanë qenë në hasmëri ndërmjet veti*”. Edhe dëshmitari B. Sh. gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se “*flitet që familja K. dhe familja E. edhe para këtij rasti kanë pasur raporte të këqija*”. Po ashtu, dëshmitari A.B. në deklaratën e dhënë ne Prokurorinë e Qarkut në Pejë me datën 22.09.2010, ka deklaruar se “*G. E. nuk e njohë por siç kam dëgjuar familja e K. ka pasur konflikt më herët me familjen e E., përkatësisht me D. E. dhe pas ngjarjes kam dëgjuar se G. E. është i të njëjtës familje...*”. Gjithashtu edhe vet i akuzuari gjatë mbrojtjes së tij lidhur me raportet me familjen K. ka theksuar se “*..bile vëllai im më ka thënë se me i kap përmaja (fryma) familjen Ke., këta i akuzojnë E.....*”, prandaj gjykata konsideron se edhe vet deklarimi i të akuzuarit në këtë kontekst tregon për raporte jo të mira që kishin këto dy familje.

Prandaj, nga të gjitha këto gjykata ka vërtetuar se raportet ndërmjet familjes K. dhe familjes E. kanë qenë raporte të këqija dhe me këtë rast është vërtetuar se hakmarrja ka qenë motivi i kryerjes së veprës penale të vrasjes së rëndë si në pikën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë kolegji penal i Gjykatës së Apelit ka vërtetuar se i akuzuari G. E., me dashje ka kryer veprat penale, Vrasje e rëndë nga neni 147 par.1 pika 4 dhe 9 të KPPK-së, dhe veprën penale, Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 291 par.5 lidhur me par.1 të KPPK-së, në kohën, vendet dhe mënyrat e përshkruara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### Elementet e veprave penale

- Në nenin 147 të KPPK-së, në paragrafin 1 është parashikuar se: *“Me së paku dhjetë vjet burgim apo me burgim afatgjatë dënohet personi i cili: Pika 4 përcakton kur: Privon nga jeta personin tjetër dhe me atë rast me dashje e vë në rrezik jetën e një ose të më shumë personave; ndërsa pika 9 përcakton kur: Privon nga jeta personin tjetër nga hakmarrja e paskrupullt apo nga motive të tjera të ulëta;*

- Në nenin 291 par.1 të KPPK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm e kryen: *“Kushdo që me anë të zjarrit, vërshimeve, armëve, eksplozivit, helmit ose gazit helmues, rrezatimit jonizues, forcës mekanike, me energji elektrike ose me ndonjë energji tjetër të çfarëdo lloji shkakton rrezik të madh për jetën e njerëzve apo për pasurinë e një rëndësie thelbore...”,* ndërsa paragrafi 5 i këtij neni ka parashikuar se: *“nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor të ndonjë personi apo me dëm material thelbësor, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në tetë vjet, e kur vepra e tillë penale rezulton me vdekjen e një apo më shumë personave, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në dymbëdhjetë vjet”.*

Duke u bazuar në këto që janë cekur më lartë, Gjykata e Apelit të akuzuarin G. E., e ka shpallur fajtor për veprat penale për të cilat është ngarkuar me aktakuzë ngase në veprimet e të akuzuarit të përshkruara në dispozitivin I. të aktgjykimit formohen të gjitha elementet e veprës penale të Vrasjes së rëndë nga neni 147 par.1 pika 4 dhe 9 të KPPK-së, dhe në veprimet e të akuzuarit të përshkruara në dispozitivin II. të aktgjykimit formohen të gjitha elementet e veprës penale, Shkatimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 291 par.5, lidhur me par.1 të KPPK-së, dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin t'a gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Vlerësimi i rrethanave për dënimin

Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit Gjykata Apelit vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 64 të KPPK-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke i marrë për bazë rrethanat rënduese dhe lehtësuese.

Si rrethana rënduese për të akuzuarin gjykata ka marrë për bazë:

*Shkallën e lartë të dashjes* se i akuzuari kishte marr armët e tij, kishte hyrë në diskotekë fillimisht me dy armët, kishte gjuajtur në drejtim të V. K. disa herë, ku me këtë rast nga gjuajtjet e tij është goditur me një predhë edhe i ndjeri B. Sh., i akuzuari për t'u larguar nga diskoteka kishte shtënë disa herë edhe në drejtime të ndryshme me ç'rast është goditur me një predhë edhe e dëmtuara A. B., po ashtu edhe jashtë diskotekës për të ikur kishte gjuajtur me armë për t'iu liruar rruga nga qytetarët që po lëviznin në atë pjesë të qytetit dhe po ashtu edhe ndaj të dëmtuarit H. B. i cili po e ndiqte ku ka mbetur i plagosur edhe ky i dëmtuar, prandaj kjo tregon vendosmërinë e të akuzuarit për të kryer veprat penale.

*Mënyrën e kryerjes së veprave penale*, i akuzuari kishte shkuar në diskotekë ku kanë qenë të pranishëm rreth 1000 persona, të cilit kishin shkuar për të festuar, kishte gjuajtur në drejtime të ndryshme duke rrezikuar edhe jetën e personave prezentë që ishin në diskotekë dhe po ashtu kishte gjuajtur nëpër rrugët e qytetit të Pejës ku po qarkullonin qytetarët po ashtu duke rrezikuar edhe jetën e tyre.

*Motivin për kryerjen e veprës penale* që ishte rreth problemave familjare që kishte familja E., me familjen K. kohë më parë.

*Moshën e viktimës* i cili ka qenë në moshë relativisht të re, 25 vjeçar.

*Shkallën e dëmit të shkaktuar* familjes së të ndjerit, ku i akuzuari me vrasjen e të ndjerit, ka shkaktuar pasoja të rënda duke lënë familjen Sh., pa djalin e tyre.

Ndërsa si *rrethana lehtësuese* gjykata ka marrë për bazë: sjelljen e të akuzuarit gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësore që ka qenë e mirë, ka pasur qëndrim tejet korrekt, si dhe faktin se më parë nuk ka qenë i dënuar për ndonjë vepër tjetër penale.

Prandaj duke marrë për bazë të gjitha këto Gjykata Apelit ka ardhur në përfundim se me dënimin unik me burgim të shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i

dënimin nga neni 34 i KPPK-së. Gjykata duke u bazuar në kuptim të nenit 71 par.2 të KPPK-së, me të cilën përcaktohet se: *“Dënimin unik gjykata e shqipton sipas këtyre rregullave”*, ndërsa në pikën 2.1 të këtij neni është përcaktuar rregullisht se: *“Nëse për ndonjërin prej veprave penale gjykata ka shpallur dënimin me burgim afatgjatë, atëherë e shqipton vetëm këtë dënim. Prandaj, kjo Gjykatë ka shqiptuar dënimin me burgim afatgjatë si në dispozitiv të këtij aktgjykimit dhe konsideron se ky dënim si i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprat penale të kryera dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikoj në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.*

Gjykata e Apelit vendimin sa i përket shpenzimit të procedurës – paushallit gjyqësor e ka marrë në mbështetje të nenit 450 të KPP-së, duke marrë për bazë komplikueshmerinë e çështjes dhe duke e vlerësuar kohëzgjatjen e procesit.

Vendimi për caktimin e masës së paraburgimit Gjykata Apelit e ka marrë duke pasqyruar parasysh dispozitivin ligjor nga 366 par.1 pika 1.1, lidhur me nenin 184 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 dhe 1.2, pika 1.2.1, lidhur me nenin 1.3 të KPPK-së, se nga analizimi i tërësishme i kësaj çështje penale kolegji penal i kësaj Gjykate ka vlerësuar se ndaj të akuzuarit duhet të caktohet masa e paraburgimit, për faktin se i akuzuari është shpallur fajtor për vepra të rëndë penale dhe është dënuar si më lartë, andaj nga të gjitha rrethanat e kësaj çështje penale ekziston rreziku se nëse i akuzuari gjendet në liri mund të arratiset. Kjo Gjykatë do të lëshoj aktvendim të veçantë për t’i mundësuar të akuzuarit edhe ushtrimin e mjetit efektiv juridik ndaj masës së paraburgimit.

Duke u bazuar në nenin 54 par.1 dhe 2 nënpar.2.7, dhe nenin 60 të KPPK-së, si dhe në nenin 276 par.2 nënpar.2.1 të KPPK-së, Gjykata Apelit ka vendosur që ndaj të akuzuarit të konfiskohet arma dhe municioni si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe më pas ka urdhëruar Stacionin Policorë në Pejë, që pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi të bëjë shkatërrimin e armës dhe municionit.

Duke e pasqyruar parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe duke u bazuar në nenin 451 par.1 dhe 453 të KPPK-së dhe konform nenit 39 par.3 nënpar.3.2 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, Gjykata ka vendosur që të akuzuarit t’i paguajnë shpenzimet e procedurës penale, shpenzimet e paushallit gjyqësor si dhe shpenzimet për programin për kompensimin e viktimave të krimit, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.



Duke u bazuar në nenin 462 par.1 dhe 2 të KPPK-së, Gjykata ka vendosur që të dëmtuarit, për realizimin e kërkesës pasurore juridike të udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil, ngase të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk kanë paraqitur bazë të sigurt për gjykimin e plotë e as të pjesshëm të kësaj kërkesë, ndërsa të dëmtuarin Valdet Kelmendi nuk e ka udhëzuar për shkak se i njëjti ka vdekur.

Nga arsyet e sipër cekura dhe në bazë të nenit 403 të KPPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA APELIT E KOSOVËS – Departamenti Special

APS.nr.18/2024, me datë 20.09.2024

B.profesionale

Anëtarët e kolegjit

Kryetar i kolegjit,

Fitore Batatina

Afërdita Bytyçi

Ferit Osmani

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Burim Ademi

\_\_\_\_\_

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej tridhjetë ditëve (30), pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën Supreme të Kosovës, nëpërmjet të kësaj Gjykate.